

Nr. 25/63 Prot

Tiranë, më 01/02/2024

**V E N D I M**

**PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT FATMIR HOXHA**

**Nr. 03, datë 22.01.2024**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

<b>Enton Radovani</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Kleada Mersinllari</b>	<b>Relatore</b>
<b>Edona Dushaj</b>	<b>Anëtare</b>

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtare e Sekretariatit Teknik, znj. Ersila Kalaja, në datën 16.01.2024 ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I VLERËSIMIT:** **Fatmir Resmi Hoxha**, me funksion aktual Shef Sektori ai dhe Zëvendës drejtor, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunorëve të Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

**OBJEKTI:** Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Ligji nr. 12/2018** “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012** “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,**

pasi dëgjoji relatimin e relatores së çështjes Kleada Mersinllari; dëgjoji subjektin e vlerësimit, Fatmir Resmi Hoxha, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 16.01.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Shefit të Sektorit ai dhe Zëvendësdrejtor, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunorëve të Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në terësi duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar,

### **V Ë R E N:**





#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Agjencia e Mbrojtjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbrojtjes Policore, bazuar në ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, shtetasi z. Fatmir Hoxha është subjekt i vlerësimit kalimtar nga trupat e vlerësimit të Agjencisë së Mbrojtjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit datë 05.04.2023, me pozicionin “Drejtor në Drejtorinë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Korçë.”
3. Subjekti i vlerësimit **z. Fatmir Hoxha**, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023, nga trupat e vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë të Brendshme nr. 7 datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit sipas ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjisllacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 1 datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: znj. Kleada Mersinllari **Relatore**, z. Enton Radovani **Kryesues** dhe znj. Edona Dushaj **Anëtare**.
5. Trupa e vlerësimit në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin nr. 1 datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha.
6. Relatorja e çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e trupës

së vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.



7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr \*\*\* prot. datë 20.04.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatorja e çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, nenin 42, nenin 46 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, relatorja e çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimit, si më poshtë vijon:
  - a. me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 19.04.2023, ka dërgua pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit dekaratën e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
  - b. me shkresën nr.\*\*\* prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit deklaratën e vlerësimit të aftësive profesionale;
  - c. me shkresën nr \*\*\* prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:
  - ✚ Vlerësimin e pasurisë;
  - ✚ Kontrollin e figurës;
  - ✚ Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
  - a. Ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar;
  - b. Ligjin nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
  - c. Ligjin nr. 40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”;
  - d. Ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”;
  - e. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;

- f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”;
- g. Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”;
- h. Duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme, dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore që janë:

-  *Deklarata e Pasurisë;*
-  *Deklarata për Kontrollin e Figurës;*
-  *Formulari i Vlerësimit Profesional;*
-  *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet.*

- i. Raportet përmbledhëse të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- j. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- k. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;
- l. Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gadishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

13. Trupa e vlerësimit, në datën 07.12.2023, pas dëgjoi relatorin e çështjes, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Hoxha, me Vendimin nr. 5 datë 07.12.2023, vendosi:

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Hoxha;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
  -  *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
  -  *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga trupa e vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 7 ditësh për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 3, pika 12 dhe 14, e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

15. Në datën 21.12.2023, trupa e vlerësimit njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 27.12.2023, në orën 10:00, Salla e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

16. Trupa e vlerësimit në ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore **të datës 27.12.2023**, të subjektit të vlerësimit Fatmir Resmi Hoxha u njoh me Urdhërin nr. 6347, datë 15.12.2023 “Për emërimin dhe transferimin në detyrë të një punonjësi polici”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për transferimin dhe emërimin e subjektit të vlerësimit z. Fatmir Hoxha, nga funksioni i Drejtorit të Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit Korçë, **në funksionin** e Shefit të Sektorit ai dhe Zëvendës drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarit dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, funksion i cili nuk është në fushëzbatimin e nenit 6, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Ndodhur në këto kushte trupa e vlerësimit gjatë seancës dëgjimore të datës 27.12.2023, u tërhoq për të shqyrtuar këtë fakt.

17. Me vendimin nr. 8 të datës 05.01.2024, trupa e vlerësimit në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar; Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të Rregullores nr. 197, datë 23.2.2023 “Për Hapat Procedurele të Unifikuar”, ndodhur në kushtet kur:

1. Neni 57 i ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, parashikon përfundimin e procesit të vlerësimit pa një vendim përfundimtar, në rastet e dorëheqjes së subjektit të vlerësimit gjatë hetimit administrativ.
2. Subjekti i vlerësimit me urdhërin nr. 6347, datë 15.12.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është transferuar në detyrë nga Drejtor i Kufirit dhe Migracionit Korçë, në detyrë Shef Sektori ai dhe Zëvendës drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, veprim i cili nuk gjen zbatim në rastin e nenit 57.
3. Urdhër i emërimit të subjektit të vlerësimit në një pozicion tjetër ka dalë në datën 15.12.2023, pasi subjekti i vlerësimit është njohur me gjetjet e hetimit kryesisht, me e-mailin e datës 11.12.2023, mbi njoftimin e relacionit paraparak. Vendosi:

Kalimin e çështjes në seancë dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha, me funksion, Shef i Sektorit ai dhe Zëvendës drejtor, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

18. Në datën 10.01.2024, trupa e vlerësimit njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 16.01.2024, në orën 10:00, Salla e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

## **II. SEANCA DËGJIMORE.**



Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Hoxha, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 16.01.2023, subjekti i vlerësimit z. Fatmir Hoxha kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 22.01.2024, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

### III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Me subjektin e vlerësimit është komunikuar me anë të postës elektronike, duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit z. Fatmir Hoxha, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

#### A. VLERËSIMI I PASURISË

19. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
20. Në zbatim të nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 08.03.2023, brenda afateve ligjore. Formulari i pasurisë ka nr. 1 index, viti 2023.
21. Procedurat e deklaramit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
22. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruar, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
23. Gjithashtu, trupa e vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaramet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar; raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34; shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave; mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.
24. **Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**

-  deklaraten e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
-  raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;

- ✚ provat shkresore/dokumente të vena në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- ✚ dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si dhe përgjigjet e pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

## 25. Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve, në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

## 26. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI,

ILDKPKI, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar raport<sup>1</sup>, të hollësishëm dhe të arsyetur, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Hoxha, ku është konstatuar se:

- a) **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- b) **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- c) **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) **subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

## **A/I. PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT**

27. Bazuar në nenin 34, të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nentit 34 të ligjit nr. 12/2018; (ç) deklaratimet e

<sup>1</sup> Raporti nr. \*\*\*\*, datë 31.07.2023, i ILDKPKI-së.



subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit; (dh) deklaratimet në seancë degjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

28. Trupa e Vlerësimit, hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

## DEKLARIMI I PASURIVE

*Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:*

### Pasuria nr.1

- ❖ Apartament banimi me sip.87 m<sup>2</sup> në rr.“Vaçe Zela”, nd.\*\*, h.\*\* ,ap.\*\* , Tiranë, blerë në vitin 2004. **Burimi i krijimit:** Nga shitja e apartamentit në lagjen “Kastrioti” Fier 1.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë nga kursimet familjare 1989-2004. Vlera 3.000.000 lekë. **Zotërimi** 100%.

### Pasuria nr.2<sup>2</sup>

- ❖ Garazh me sip. 32 m<sup>2</sup> në rr.“Vaçe Zela”, nd.\*\* , Tiranë, blerë në vitin 2004, në vlerën 500.000 lekë. **Burimi i krijimit:** Nga kursimet familjare në vitin 1989-2004. Vlera 500.000 lekë. **Zotërimi** 100%.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitje të pasurisë së paluajtshme me nr.\*\*rep dhe nr.\*\*kol,. datë 22.01.2004, për apartament banimi me sip. 87 m<sup>2</sup>, në zonën kadastrale \*\*, nr. pasurie \*\*\*, volumi \*\*, faqe \*\*\* me adresë: apartamenti nr. \*\*, në katin e tretë, shkalla nr.\*\* në rrugën “Bab Rexha”, Tiranë, me palë shitëse shtetasin F.S dhe palë blerëse Fatmir Resmi Hoxha.
- Vërtetim nga dokumenti hipotekor datë 22.01.2004, për pasurinë me nr. \*\*\*, zk \*\*, lloji apartament me sip. 87 m<sup>2</sup>, në katin e tretë, në banesën rruga “Bab Rexha”, Tiranë, në pronësi të shtetasit F.S. B/lidhur: Harta treguese e regjistrimit dhe planimetria.

<sup>2</sup> \*suarim: trajtimi i pasurisë “apartament banimi” dhe pasurisë “garazh” është realizuar së bashku lidhur kjo me faktin se momenti i krijimit të tyre është i njëjtë.



- Kontratë shitje të pasurisë së paluajtshme me nr. \*\*\* rep dhe nr \*\*\* kol datë 26.04.2002, për apartament banimi me sip. 46.4 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “Kastriot”, Fier, ap.\*\*shkalla \*\*, kati\*\*, pallati nr.\*\* me palë shitëse shtetasin Fatmir Resmi Hoxha dhe Merita Hysen Hoxha dhe palë blerëse shtetasin A. B me vlerën 1.000.000 lekë.
- Kontratë shitblerje të pasurisë së paluajtshme (garazh) me nr.\*\*\* dhe nr.\*\*\* kol, datë 22.01.2004, për garazh nr.\*\* me sip. 36m<sup>2</sup>, ndodhur në banesën gjashtë dhe tetë kate, në zonën kadastrale \*\*\*\* nr.pasurie \*\*\*\*, volumi \*\* faqe \*\*\*, në rrugën “Bab Rexha” Tiranë, me palë shitëse shtetasin F.S dhe palë blerëse shtetasin Fatmri Resmi Hoxha, në vlerën 500.000 lekë.
- Vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 12.01.2004, për pasurinë nr.\*\*\*\*\* e ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*\*\*, lloj garazh me sip.36m<sup>2</sup>, në banesën gjashtë dhe tetë kate, rruga “Bab Rexha”, Tiranë, në pronësi të shtetasit F.S.

### **Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.**

- ✚ **Verifikimi i kryer pranë ASHK**, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, me shkresën nr.\*\*\* datë 26.06.2023, konfirmon se në emër të Fatmir Resmi Hoxha rezulton e regjistruar: pasuria me nr. \*\*\*\*\* e ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*\*\*, apartament me sipërfaqe 87 m<sup>2</sup>.
- ✚ Gjithashtu, konfirmohet se në emër të subjektit z. Fatmri Hoxha rezulton e regjistruar pasuria me nr.\*\*\*\*\* garazh me sip. 36 m<sup>2</sup>.

### **Bashkëlidhur:**

- Kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme me nr. \*\*\* rep dhe nr. \*\*\* kol datë 22.01.2004, për apartament banimi me sipërfaqe 87m<sup>2</sup>, ndodhur në zonën kadastrale nr. pasurie \*\*\*\* volumi \*\*, faqe \*\*\*, apartamenti nr.\*\* në katin e tretë, shkalla nr \*\*, në rrugën “Bab Rexha”, Tiranë, në vlerën 3.000.000 lekë.
- Vërtetim nga dokumenti hipotekor datë 22.01.2004, për pasuri nr.\*\*\*\*\* zona kadastrale, \*\*\* lloji apartament me sipërfaqe 87m<sup>2</sup> në rrugën “Bab Rexha”, Tiranë në pronësi të shtetasit F.S
- Kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme (garazh) me nr. \*\*\* rep dhe nr.\*\*\* kol, datë 22.01.2004, për garazh nr.\*\* me sip 36 m<sup>2</sup>, ndodhur në zonën kadastrale 8220, nr. pasurie \*\*\*\* volumi, \*\*\*faqe \*\*\*, në rrugën “Bab Rexha”, Tiranë, me palë shitëse F.S dhe palë blerëse Fatmir Resmi Hoxha me vlerën 500.000 lekë.
- Vërtetim nga dokumenti hipotekor datë 22.01.2004, për pasuri nr.\*\*\*\*\* zona kadastrale \*\*\* lloji garazh me sipërfaqe 36 m<sup>2</sup>, në rrugën “Bab Rexha”, Tiranë, në pronësi të shtetasit F.S.
- ✚ Në vazhdimin e hetimit **ASHK Fier**, me shkresën nr.\*\*\* datë 19.06.2023, nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të subjektit Fatmir Resmi Hoxha dhe familjarët e tij.
- ✚ Në proces-verbalin e **datës 30.06.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka dhënë detaje për blerjen e kësaj pasurie ku ka sqaruar se:

- *“Apartamentin me sip 46.4 m<sup>2</sup> në lagjen “Kastrioti”, Fier e kam përfituar nga ligji “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Nuk disponoj dokumentacionin e privatizimit të këtij apartamenti në vitin 1992, kontratën me Ndërmarrjen Komunale të Banesave Fier, pasi nuk e kam ruajtur këtë dokument<sup>3</sup>. Apartamenti i sipërpërmendur me sipërfaqe 46.4 m<sup>2</sup> është shitur në vlerën 1.000.000 lekë, bazuar në kontratën e shitjes nr\*\*\* rep, dhe nr.\*\*\* kol, datë 26.04.2002. Sqaroi se të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti në vlerën 1.000.000 lekë, kursimet familjare ndër vite nga të ardhurat nga paga, si dhe ndihma financiare në shumën 6.000 cad (dollarë kanadez) nga kunati im S. Levanaj me banim në Kanada nga viti 2001, kam blerë apartamentin e banimit me sip 87m<sup>2</sup> në Rrugën “Vaçe Zela” nr.\*\*\* hyrja \*\* ap \*\* Tiranë, në muajin janar 2004 në vlerës 3.000.000 lekë, si dhe garazhin në të njëjtën adresë me vlerën 500.000 lekë.”*
- *Lidhur me burimin e krijimit për blerjen e apartamentit dhe garazhit në Rr “Vace Zela” Tiranë sqaroi se janë të ardhurat nga shitja e apartamentit në Fier, në vlerën 1.000.000 lekë kursimet nga paga si dhe ndihmë financiare në shumën 6.000 cad (dollarë kanadez) nga kunati S. Levanaj me banim në Kanada.”*

✚ Gjithashtu, në proces-verbalin e **datës 17.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie subjekti sqaroi se:

- *“shumën prej 6.000 cad, kunati S. Levanaj i’a ka dhënë cash të motrës së tij, Merita Hoxha në vitin 2003, kur ishte në Shqipëri. Lidhur me hyrjen e tij në vitin 2003 nuk disponon dokument verifikues. Për burimin e të ardhurave të kunatit S. Levanaj për dhurimin e shumës 6.000 cad deri në vitin 2003 sqaroi se ai është rezident në Kanada nga data 05.06.2001 dhe në datën 03.01.2002 ka filluar punë si inxhinier pranë Kompanisë Doming Sprint Corp. Për kontratën e punës se tij, pranë kësaj kompanie nga muaji janar 2002 e në vazhdim, kunati S.Levanaj e ka sqaruar se ishte e vështirë t’i gjente këto dokumenta, pasi kanë kaluar rreth 20 vite.”*

Krahas shpjegimeve të sipërpërmendura subjekti paraqiti dokumentacionin justifikues, si më poshtë vijon:

- Deklaratë personale datë 14.06.2023, nga kunati i subjektit z. S.Levanaj, për dhuratë në shumën 6.000 cad që i ka dhënë në vitin 2003, motrës së tij Merita Hoxha me qëllim blerjen e apartamentit dhe garazhit në Tiranë. (*bashkëlidhur pasaporta kanadeze*)
- Deklaratë personale datë 19.06.2023, në të cilën shtetasi z. S.Levanaj, deklaron se është rezident në Kanada, nga data 05.06.2001 dhe ka filluar punë në datën 03.01.2002, pranë Kompanisë Doming Sprint Corp si inxhinier.
- Curriculum Vitae e S.Levanaj.
- Dokument “leje qëndrimi” nga shteti Kanadez, për S.Levanaj dhe bashkëshorten e tij për periudhën 06.03.2001 - 31.01.2002.

### **Konkluzion mbi burimin e krijimit të pasurive.**

<sup>3</sup> Proces-verbali datë 30.06.2023 fq2.

29. **Trupa e vlerësimit në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar**, në përfundim të analizimit dhe vlerësimit të deklarimit të subjektit, dokumentacionit justifikues, të dhënave të mbledhura nga institucionet ligjzbatuese, **konstaton se konfirmohen pasuritë e deklaruar nga subjekti i vlerësimit (apartament banimi +garazh).**

Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, apartament banimi me sipërfaqe 87 m<sup>2</sup> dhe garazh me sipërfaqe 36 m<sup>2</sup>, është i aplikueshëm neni 32 pika 1.1 “*Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nga viti 2008 dhe në vijim...*” **sepse asetet e sipërpërmendura janë krijuar para vitit 2008.**

### **Hetimi i zhvilluar kryesisht nga trupa e vlerësimit mbi paqartësi në lidhje me pasuritë “apartament” dhe “garazh”**

- ❖ Trupa e vlerësimit për një proces sa me transparent dhe të rregullt, krahas verifikimit të deklarimit ka ezauruar çdo paqartësi, të dalë gjatë verifikimit të kryer në lidhje me pasuritë e deklaruar nga subjekti i vlerësimit, apartament banimi dhe garazh si më poshtë vijon:

30. Në lidhje me pasurinë apartament banimi **të trajtuar më sipër**, nga konkluzionet e trupës së vlerësimit ka rezultuar se adresa e apartamentit të banimit ka qenë e ndryshëm në perioda dhe deklarime të ndryshme si vijon:

1. Në deklaraten e pasurisë me nr. index 1 viti 2023, dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, adresa është deklaruar në rrugën “*Vace Zela*”.
2. në korrespondencën me ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, me shkresën nr.\*\*\* datë 26.06.2023, dhe dokumentacionin shoqërues së deklaratës “Kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme me nr. \*\*\* rep dhe nr \*\* kol datë 22.01.2004”, adresa e këtij apartamenti rezulton rruga “*Bab Rexha*”.
3. Në deklaratat e pasurisë të subjektit ndër vite pranë ILDKPKI-së, si adresë banimi rezulton rruga “*Stavri Themeli*”.

26.1 Referuar fakteve të mësipërme me e-mail-in e datës 27.09.2023, relatorja e çështjes ka pyetur subjektin e vlerësimit për konkluzionet e mësipërme dhe në e-mail-in e datës 02.10.2023, subjekti i vlerësimit ka dhënë shpjegime si më poshtë vijon:

- “*Në përgjigje të pyetjes ju sqaroi se, përsa i përket blerjes së apartamentit banim me sip. 87m2 në Rrugën “Vace Zela”, Nd.\*\* H.\*\* Ap.\*\* Tiranë, blerë në janar të vitit 2004, në vlerën 3.000.000 lekë sipas kontratës së shitblerjes nr.\*\*\* rep, nr.\*\* kol në datë 22.01.2004. Aktualisht emri i rrugës është “Vace Zela”, Nd. \*\*, më përpara emërtimi i rrugës ishte “Bab Rexha” ku disponoj “Vërtetimin nga Dokumentet Hipotekore” të vitit 11.02.2004, gjithashtu dhe “Çertifikatën e Regjistrimit Pronësisë” datë 15.03.2022, dhe është i njëjti apartament. Apartamenti në rrugën “Stavri Themeli” është e njëjta adresë me apartamentim që disponoj, pasi nuk kam tjetër apartament”.*

### **Konkluzion:**

26.2 Trupa e vlerësimit, pas verifikimit të kryer dhe duke marr parasysh faktin se sistemi i adresave nuk ka qënë shumë i qartë në periudhat e mëparshme, **konstaton se** adresat e deklaruara në periudha të ndryshme nga subjekti i vlerësimit i referohen të njëjtës pasuri.

31. Nga hetimi i trupës së vlerësimit është konstatuar se subjekti i vlerësimit, në dekaratat e interesave private para fillimit detyrës të vitit 2003, dorëzuar pranë ILDKPKI-së ka pasqyruar apartament banimi me sipërfaqe 90 m<sup>2</sup> dhe vlera e deklaruar është 9.000.000 lekë.

✚ Në proces-verbalin e datës 30.06.2023, mbajtur pranë ILDKPKI-së dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, në lidhje me apartamentin me sip 90 m<sup>2</sup>, me adresë: rruga “Stavri Themeli” pallati i ri, Tiranë, me vlerë 9.000.000 lekë, të deklaruar në deklaratën e interesave private të vitit 2003, subjekti i vlerësimit sqaroi se:

➤ *“është i njëjti apartament me sip.87 m<sup>2</sup>, në Rr. “Vace Zela”, nd.\*\*\* Tiranë, në vlerën 3.000.000 lekë i blerë në muajin janar 2004, sipërfaqen e apartamentit e kam deklaruar me përafërsi, ndërsa vlerën e apartamentit ishte lapsus në deklarim, pasi kam deklaruar vlerën të cilën pretendoja se mund ta shisja apartamentin”.*

27.1 Me e-mail-in e datës 27.09.2023, relatorj e çështjes ka pyetur subjektin e vlerësimit për konkluzionet e mësipërme ku me e-mail-in e datës 02.10.2023, subjekti ka dhënë shpjegime si më poshtë vijon:

➤ *“Në përgjigje të pyetjes numër dy ju sqaroi se, apartamenti me rrugën “Stavri Themeli” është e njëjta banesë dhe si vlerë, vlera e vetme që kam blerë banesë është 3.000.000 lekë, në 2004 dhe që banoj e aktualisht, vlera 9.000.000 lekë është dhënë gabimisht.”*

### **Konkluzion:**

27.2 Referuar fakteve të mësipërme dhe përgjigjeve të dhëna nga subjekti i vlerësimit, trupa e vlerësimit konstaton se, përgjigjet e dhëna nga subjekti i vlerësimit pranë ILDKPKI-së si: ***“vlerën e apartamentit ishte lapsus në deklarim pasi kam deklaruar vlerën të cilën pretendoja se mund ta shisja apartamentin”*** dhe në e-mail-in e datës 02.10.2023, drejtuar relatores së çështjes shprehet ***“vlera 9.000.000 lekë është dhënë gabimisht”*** janë të pranueshme.

28 Lidhur me sipërfaqes e garazhit, (trajtuar mësipër) subjekti në deklaratën e pasurisë e ka deklaruar me sipërfaqe **32 m<sup>2</sup>**, ndërkohë që në kontratën e shitjes rezulton me sipërfaqe **36 m<sup>2</sup>**.

28.1 Referuar këtij konkluzioni, subjekti i vlerësimit ka dhënë shpjegim se deklarimi i sipërfaqes 32m<sup>2</sup> ka qënë një lapsus nga ana e tij, në momentin e plotësimit të deklarimit.

### **Konkluzion:**

**28.2 Trupa e vlerësimit, konstaton se pasaktësia e subjektit të vlerësimit, mbi sipërfaqen e garazhit konsiderohet si një gabim material.**

### Pasuria nr.3

- ✚ Makinë tip Mercedes Benz me targa AA\*\*\*MF, blerë në 02.09.2016. **Burimi i krijimit:** nga shitja e makinës tip AUDI në vlerën 200.000 lekë dhe kursimet familjare në vitin 2014-2016, në vlerën 300.000lekë. **Vlera e automjetit:** 500.000 lekë.

### Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit.

- ✚ **Verifikimi i kryer pranë DPSHTRR**, me shkresën me nr.\*\*\* prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Fatmir Resmi Hoxha ka të regjistruar mjetin me targa AA\*\*\*MF, marka Mercedes Benz me nr shasje WDD\*\*\*\*\*, blerë me kontratë shitje automjeti me nr.\*\*\* rep., dhe nr. \*\*\*kol., datë 02.09.2016, me palë shitëse shtetasin H. P me vlerën 500.000 lekë. Viti i prodhimit 2009. Gjithashtu, konstatohet se Fatmir Hoxha ka pasur të regjistruar mjetin me targa AA\*\*\*NS, marka Audi 3D, me nr. shasje W\*\*\*\*\*, blerë me kontratë shitje automjeti me nr.\*\*\* rep., dhe nr. \*\*kol., datë 26.01.2005, në vlerën 250.000 lekë. Këtë automjet i'a ka shitur shtetasit G. L me kontratë shitje e automjetit me nr. \*\*\*rep dhe nr. \*\*\* kol datë 05.03.2016 në vlerën 2000 euro<sup>4</sup>.

### **Bashkëlidhur dokumentacioni:**

- Kontratë shitje automjeti me nr. \*\*\*rep., dhe nr. \*\*\*kol., datë 02.09.2016, me palë shitëse shtetasin H. P dhe palë blerëse Fatmir Hoxha.
- Kontratë shitje automjeti me nr.\*\*\* rep., dhe nr.\*\*\*kol., datë 26.01.2005, me palë shitëse A. T dhe palë blerëse Fatmir Hoxha.
- Kontratë e shitje e automjetit me nr. \*\*\*rep dhe nr. \*\*\*kol., datë 05.03.2016, me palë shitës Fatmir Hoxha dhe palë blerëse G. L

29 Në zbatim të pikës 1.1 të nenit 32 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, nga ku rezulton detyrimi i subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur me të, që të justifikojnë burimin e krijimit të pasurive, trupa e vlerësimit analizoj mbi mundësinë e blerjes së mjetit me targa AA\*\*\*MF, marka Mercedes Benz duke pasqyruar në tabelën financiare, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur më të.

29.1 Trupa e vlerësimit referuar hetimit pasuror mbi pasurinë automjet, tip Mercedes Benz, me targa AA\*\*\*MF, **me vlerë 500.000 lekë**, ka arritur në konkluzionin se burimi i të ardhurave për përfitimin e kësaj pasurie rezulton nga:

- vlera prej 276.000 lekë që është përfituar nga shitja e automjetit të mëparshëm, nëpërmjet kontratës nr. \*\*\* rep dhe nr. \*\*\* kol datë 05.03.2016.

---

<sup>4</sup> \*Vlera 2000 euro e konvertuar me kursin e këmbimit valutor të datës 05.03.2016 rezulton në vlerën **276.000 lekë**.

- dhe vlera prej 224.000 lekë që është konstatuar si mundësi kursimi për periudhën 2014-2016, referuar tabelës mbi pasqyrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve<sup>5</sup> (*bashkëlidhur raportit shtojca nr.1*).

**Konkluzion:**

**29.2 Trupa e vlerësimit konstaton se konfirmohet burimi i krijimit të kësaj pasurie me të ardhurat e deklaruar nga subjekti i vlerësimit.**

**Pasuria nr.4**

- + Llogari rrjedhëse nga paga në Raiffeisen Bank, me nr. llogarie \*\*\*\*\* me gjendje në datën 07.03.2023, në vlerën 757.953 lekë. **Burimi i krijimit** – të ardhura nga paga. **Zotëron** 100%.
- + **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* datë 08.05.2023, konfirmon se z. Fatmir Hoxha ka llogari page në gjendje në datën 08.03.2023, në shumën 777.953 lekë.

**Hetimi i trupës së vlerësimit.**

- 30 Në lidhje me krijimin e kësaj pasurie trupa e vlerësimit, ka realizuar kryqëzimin e informacionit të vënë në dispozicion nga bankat e nivelit të dytë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, duke krijuar analizimin e të dhënave, nëpërmjet pasqyrës financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve në vite të subjektit të vlerësimit.
- Trupa e vlerësimit ka konfirmuar nëpërmjet nxjerrjes së llogarive bankare, faktin se të ardhurat e sipërpërmendura kanë qenë kreditime të pagës së subjektit të vlerësimit ndër vite.

**Konkluzion:**

- 30.1**Hetimi i trupës së vlerësimit, referuar hetimit financiar të kryer nëpërmjet tabelës së të ardhurave dhe shpenzimeve, (shtojcë nr.1), **ka konstatuar se subjekti i vlerësimit ka mundësi për krijimin e kësaj pasurie e cila në datën 07.03.2023, mban vlerën 777.953 lekë.**
- + Në kuadër të vlerësimit të pasurisë referuar ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, trupa e vlerësimit dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, kanë realizuar **hetim kryesisht** duke kërkuar informacione, për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur me të.

**Nga zhvillimi i hetimit ka rezultuar se:**

- + **Cred Invest** me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon se z. Fatmir Hoxha është klient prej datës 23.05.20215, në Fondin e Pensioneve “*Credins Pension*”. Gjendja në fondin e pensionit rezulton, në datën 08.03.2023: *në kuotë 3.283; me balancë 5/354 lekë.*

---

<sup>5</sup> Shkresa nr. \*\*\*\* datë 06.04.2021 mbi shpenzimet jetike të INSTAT

31 Në proces-verbalin e datës 30.06.2023, mbajtur pranë ILDKPKI-së, dhe konfirmuar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se:

- *“ka hapur Fond Pensioni në Credins Invest me vlerën 1.000 lekë, në datën 25.05.2015 dhe gjendja e saj deri në datë 28.8.2015 është në shumën 4.000 lekë. Më pas nuk ka kryer asnjë veprim dhe nuk kishte asnjë njoftim në lidhje me këtë fond investimi. Duke mos kryer asnjë veprim ka menduar se kjo llogari nuk ishte aktive”.*
- Subjekti konfirmoi gjendjet e fondit të pensionit në datë 08.03.2023, në emrin e tij në shumën 5.354 lekë dhe në emrin e bashkëshortes në shumën 6.695 lekë.

### **Konkluzion:**

31.1 Trupa e vlerësimit konstaton se, subjekti i vlerësimit nuk ka pasqyruar në deklaratën e pasurisë të dhënat e detyrueshme për deklarim, por referuar shterimit të hetimit arrin në përfundimin se ky veprim ka qenë jo i qëllimshëm nga ana e subjektit të vlerësimit. Ky veprim ka ardhur si rezultat i harresës, për shkak të moskryerjes së veprimeve nga ana e subjektit, për një kohë të gjatë mbi këtë llogari.

✚ Në zbatim të nenit 32 të Ligjit 12/2018 i ndryshuar, *“subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të deklarojnë çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar, nga data e fillimit të punës në institucionin ...”* gjatë hetimit të kryer mbi verifikimin e deklarimeve të pasurisë nga:

✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr.\*\*\* datë 19.06.2023, konfirmohet se Fatmir Hoxha ka depozituar në datën 26.04.2002, shumën 3.050.000 lekë. Depozita rezulton e mbyllur në datën 01.07.2002.

- *Lidhur me konkluzionet nga Tirana Bank, subjekti sqaroi se në datën 26.04.2002, ka krijuar depozitë pranë kësaj banke në shumën 3.050.000 lekë, me burim të ardhurash nga shitja e apartamentit në lagjen “Kastroit” në qytetin e Fierit, në vlerën 1.000.000 lekë. Kursime nga të ardhurat familjare deri në atë periudhë, si dhe kursimet që prindërit e tij posedonin der në vitin 2002, nga të ardhurat e tyre nga puna ndër vite.*
- *Sqaroi se, qëllimi i krijimit të kësaj depozite ishte për t'i ruajtur këto kursime në sitemin bankar, që në të ardhmen bashkë me kursime të tjera që do të krijonte nga paga, të kishin mundësi për të blerë banesë. Për shkak se në vitin 2002 subjekti është transferuar me punë, në Polici në qytetin e Korçës, ka mbyllur depozitën dhe i ka kthyer pjesën takuese të kursimeve prindërve R. Hoxha dhe M. Hoxha të cilët kanë ndëruar jetë.*

32 Në lidhje me transferimin në qytetin e Korçës, subjekti i vlerësimit nëpërmjet postës elektronike, të datës 19.07.2023, ka sqaruar se:



➤ Nga data 26.04.2002 - 22.01.2004, së bashku me familjen ka banuar në qytetin e Korçës, pasi ishte i transferuar me punë, në detyrën e Shefit të Komisarariatit të Policisë, në qytetin e Korçës. Adresa ku ka banuar ishte: lagjia nr. \*\*, rruga "1 Maj", pallati \*\*. Këtë banesë i'a kishte lenë në ruajtje shtetasi H. T (mik familjar). **Sqaroi se ky shtetas ka emigruar në SH.B.A, prej rreth 20 vitesh dhe nuk ka kontakt aktualisht me të.** (Marrëdhënia me shtetasin H. T sqaruar me poshtë.)

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\* datë 08.05.2023, përcjell informacion se Fatmir Hoxha, ka llogari rrjedhëse në cad, dhe në datën 09.06.2005, ka derdhur në llogari shumën 12.000 cad. Në datën 04.08.2005, ka tërhequr nga llogaria shumën 2.000 cad, ndërsa në datë 05.08.2005, ka transferuar shumën 10.000 cad, për llogari të Shoqërisë. "Marko Co" sh.p.k.

**Fatmir Hoxha**, ka llogari rrjedhëse në usd dhe në datë 05.08.2005 i kanë kaluar në llogari shumën 23.660 usd, e cila është transferuar për llogari të Shoqërisë. "Marko Co" shpk, me përshkrim: "*kalim fondesh për blerje apartamenti*".

33 Në lidhje me burimin e krijimit të shumave, 12.000 cad dhe 23.660 usd, të kredituara prej tij në llogari në cad dhe usd në Raiffeisen Bank, në datën 09.06.2005 dhe 05.08.2005.

➤ subjekti sqaroi se: "*këto vlera likuiditetesh janë sjell dorazi nga kunati i tij S.Levanaj, me banim në Kanada, me qëllim blerjen e një apartamenti banimi për babain e tij H.Levanaj (vjeherri i subjektit). Sqaroi se kunati S.Levanaj, në datën 24.04.2005, ka ardhur në Shqipëri dhe është larguar nga Shqipëria, në datën 02.05.2005 dhe këto shuma likuiditetesh i'a ka dhënë në mirëbesim cash. Të gjitha transfertat e kryera për llogari të shoqërisë "Marko Co" sh.p.k, janë bërë për këtë qëllim dhe duke qenë se ishte personi më i afërt dhe i besuar për ta, këto veprime janë kryer në vitin 2005 nga subjekti. Për shumën 2000 cad, të tërhequr në datën 04.08.2005, sqaroi se kjo shumë i është dhënë prindërve të S.Levanaj, për nevojat e tyre me miratimin e tij. Në këtë rast subjekti ka qenë thjesht garantor për ta*".

✚ Në mbështetje të deklaramit të mësipërm, subjekti paraqiti dokumentacion si më poshtë:

- Dokumentin nga sistemi TIMS, që konfirmon hyrjen e kunatit të tij S.Levanaj në territorin e Shqipërisë në datën 24.04.2005 dhe daljen e tij në datën 02.05.2005.
- Kontratë blerje me nr.\*\*\*rep., dhe nr.\*\*\* kol., datë 17.11.2006, për apartamentin me sipërfaqe 93 m<sup>2</sup>, zk \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*\*, me adresë në rruga "Irfan Tomini", Tiranë me palë shitëse E. M dhe palë blerëse H. Levanaj (vjeherri i subjektit) me vlerën 3.500.000 lekë, e cila është likujduar jashtë zyrës noteriale dhe para hartimit të kësaj kontrate.
- E-mail-et që i përkasin datave 12.06.2006 dhe 19.07.2006, të shkëmbyera me kunatin e tij, S.Levanaj, për përgatitjen e prokurave në emër të vjeherit.

**Konkluzion:**

33.1 Trupa e vlerësimit referuar të dhënave të mësipërme, rrethanave të faktit, përgjigjeve të subjektit të vlerësimit, si dhe dokumentacionin shoqërues të vënë në dispozicion nga subjekti i vlerësimit, mbi të ardhurat e kunatit të tij S. Levanaj, konstaton se ky i fundit ka mundësi ekonomike për të siguruar vlerat prej 12.000 cad dhe 23.660 usd, nga puna e tij si inxhinier në shtetin kanadez prej viti 2001. **Në lidhje me krijimin e këtyre llogarive bankare, në emër të subjektit të vlerësimit aplikohet neni 32 pika 1.1 i ligjit 12/2018, i ndryshuar.**

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 08.05.2023, përcjell CD që konfirmon se Fatmir Hoxha, në llogarin e pagës së subjektit të vlerësimit, në datën 23.05.2011, është kredituar nga ai vetë shuma 191.280 lekë.

➤ Në proces-verbalin e datës 30.06.2023, mbajtur pranë ILDKPKI-së subjekti i vlerësimit sqaroi se: *“kreditimi i shumës 191.280 lekë, në llogarinë e pagës në datën 23.05.2011, kishte si qëllim mbylljen e overdraftit që kishte gjendje të pashlyer”.*

✚ **AK Invest**, me shkresën nr.\*\*\*prot., datë 10.05.2023, përcjell CD ku konfirmon se shtetasi Fatmir Hoxha, ka kryer një transaksion monetar si përfitues nga SHBA, në shumën 200 usd në datën 31.12.2020 nga shtetasi J.L.

➤ *Në proces-verbalin e datës 30.06.2023, subjekti sqaroi se në datën 30.12.2020, mëpërmjet AK Invest sha, i është dërguar shuma 200 usd, nga shtetasi H. T, nëpërmjet shtetasit J .L. Shtetasin H. T e ka mik femijërie dhe këto para i dërgoi për t’ja dhënë nënës së tij, me banim në qytetin e Pogradecit.*

35. **Trupa e vlerësimit**, referuar përgjigjeve të dhëna në proces-verbalin e datës 19.07.2023, (trajtuar me sipër) për marrëdhënien me shtetasin H. T, në lidhje me qëndrimin në shtëpinë e këtij shtetasi, pika 32 e relacionit pasqyruar më sipër, ku ka deklaruar se: *“ky shtetas ka emigruar në SH.B.A, prej rreth 20 vitesh dhe nuk ka kontakt aktualisht me të”*, për të marrë prej tij një deklaram, që të vërtetoj faktin e qëndrimit në shtëpinë e tij.

Si dhe referuar proces-verbalit të datës 30.06.2023, (trajtua më sipër) pyetur për transaksionin monetar nëpërmjet AK Invest, ku subjekti i vlerësimit deklaroj se: *“shtetasin H. T e ka mik femijërie dhe këto para i dërgoi për t’ja dhënë nënës së tij”*, në vitin 2020.

35.1 Në e-mail-in e datës 27.09.2023, relatorja e çështjes kërkoj shpjegime mbi marrëdhënien me shtetasin H. T, për shkak të deklaramit në ILDKPKI, që nuk mund të marr kontakt me personin e sipërpërmendur lidhur me periudhën e qëndrimit në qytetin e Korçës, në shtëpinë e tij.

35.2 Në e-mail-in e datës 02.10.2023, subjekti i vlerësimit ka dhënë shpjegime si vijon: *ju sqaroi se, shtetasi H. T është mik i imi dhe i familjes sime, unë nuk kam komunikim të vazhdueshëm me të pasi ai është në SHBA. Vlera 200 usd është dërguar nëpërmjet Ak invest sh.a nga shtetasi H. T për nënën e tij, ndërmjet shtetasit J. L.*

## **Konkluzion:**

35.3 **Trupa e vlerësimit** mbi elementet e sipërpermendura, si dhe deklarimeve të subjektit të vlerësimit lidhur me marrëdhënien me shtetasin H. T, gjykon se:

- a. kjo marrëdhënie nuk ka krijuar të ardhura (marrëdhënie pasurore) për subjektin e vlerësimit;
- b. periudha për të cilën subjekti ka jetuar në shtëpinë e këtij shtetasi është përpara viti 2008, thjesht përkon me detyrimin për deklarim gjë të cilën e ka realizuar;
- c. nga verifikimi i të dhënave për shtetasin H. T, në sistemet e Policisë së Shtetit, nuk kanë rezultuar të dhëna për përfshirjen e tij në veprimtari të kundraligjshme, që të shërbej si indicje për thellimin e mëtejshëm të trupës së vlerësimit, për verifikim dhe hetim në kuadër të kontrollit të figurës.

Sa sipër, trupa e vlerësimit në mbështetje të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, dhe rrethanave të faktit e konsideron të ezauruar pjesën e verifikimit të marrëdhënies së subjektit të vlerësimit me shtetasin H. T.

✚ **ASHK, Drejtoria e Përgjithshme**, me shkresën nr. \*\*\* datë 12.06.2023, konfirmon se i ka kërkuar informacion Zyrës Vendore të ASHK-së. Nga verifikimet e kryera në bazë digjitale të të dhënave të vetëdeklarimeve, të administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së, rezulton vetëdeklarues:

- Fatmir Hoxha, (nr. prot 3356, dt 2005 Formular A, Durrës)
- Merita Hysen Hoxha dhe të tjerë, (nr. 734 prot, kalim emri, Njësia 5, Tirana Jug)

36. Me shkresën nr.\*\*\*., prot., datë 12.06.2023, **Agjencia Shtetërore e Kadastrës Durrës**, konfirmon se Fatmir Hoxha, nuk rezulton të ketë të regjistruar pasuri të paluajtshme, nuk rezulton të jetë aplikuese për proces legalizimi.

36.1 Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 12.06.2023, **nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tirana Jug**, konfirmon se Merita Hoxha nuk rezulton të ketë të regjistruar pasuri të paluajtshme, nuk rezulton të jetë aplikuese për proces legalizimi.

36.2 Relatorja e çështjes në zbatim të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 25.09.2023, kërkoj informacion nga ASHK Tirana Jug, referuar të dhënave mbi kërkesën me nr. 734 prot., kalim emri. Ku me kthim-përgjigjen nr.\*\*\* prot., datë 29.09.2023 nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tirana Jug, rezulton se Merita Hoxha nuk është subjekt i kërkesës me nr. 734 prot., kalim emri, Njësia 5, Tirana Jug, **duke u konfirmuar se nuk bëhet fjalë për të njëjtin person.**

36.3 Relatorja e çështjes në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, më shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.09.2023, kërkoj informacion nga ASHK Durrës referuar të dhënave mbi formularin, (nr. 3356 prot., datë 2005 Formulari A) ku me kthim-përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2023, konfirmon se kërkesa për legalizim sipas formularit të mësipërm, rezulton e kryer nga subjekti i vlerësimit.

- ✚ Gjendur në këto kushte, trupa e vlerësimit në zbatim pikës 2, të nenit 53/1, i kalon barrën e provës subjektivit të vlerësimit, nëpërmjet e-mail-it të datës 01.11.2023, të japi sqarime në lidhje me faktin e konstatuar më sipër.

36.4 Në e-mail-in e datës 10.11.2023, subjekti i vlerësimit dha shpjegimet e tij si më poshtë vijon:

- *“Për sa i perket e-mail-it tuaj unë nuk disponoj asnjë pronë në Durrës dhe nuk kam aplikuar asnjëherë për proces legalizimi për ndonjë pronë në Durrës dhe në gjithë Shqipërinë, përveç pronave që kam deklaruar në formularët e deklaramit të pasurisë. Bashkëlidhur po ju dërgojë vërtetimin e marrë nga ASHK Durrës”.*

- ✚ Subjekti i vlerësimit bashkëlidhi vërtetimin e ASHK Durrës, të datës 09.11.2023, ku konstatohet se në emër të subjektivit të vlerësimit nuk ka prona të regjistruara.

### **Konkluzion:**

**36.5 Trupa e vlerësimit referuar të dhënave të faktit, hetimit të kryer dhe dokumentacionit të mbledhur nga ASHK Durrës dhe institucionet ligjzbatuese konstaton se verifikimet e të dhënave digjitale të sipërpërmendura nuk janë në ngarkim të subjektivit të vlerësimit dhe personit të tij të lidhur.**

### **A/2 DEKLARIMI I TË ARDHURAVE**

- Të ardhurat nga funksioni si Oficer Policie, Ekspert Kriminalist Tiranë, Ekspert Krimesh, Shef i Policisë Kriminale Fier, Shefi i Policisë Kriminale Delvinë, Shefi i Policisë Kriminale Pogradec, Shefi i Policisë Kriminale Ersekë, Shef Komisariati i Policisë Korçë, Shefi i Luftës kundër Trafiqueve të Qenieve Njerëzore, Drejtorja e Krimit të Organizuar, për periudhën 01.07.1989 - 31.01.2004.
  - Të ardhurat nga taksa e solidaritetit në vitet 1997-1998, në vlerën 400.000 lekë. **Shuma 3.032.164 lekë.**
- Të ardhurat si Shef i Luftës kundër Trafiqueve të Qenieve Njerëzore, Specialist Sektori Kundër Trafiqueve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
  - Të ardhura të përfituara nga trajtimi suplementar dhe pensioni i përkohshëm si Oficer i Policie, gjatë periudhës së papunësisë.
  - Të ardhurat si Zevëndës drejtor Policie në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë dhe DVP Berat për periudhën 01.02.2004 - 30.04.2018. **Shuma 9.284.025 lekë.**
- Të ardhurat si Zevëndës drejtor për Hetimin e Krimit, në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat deri në 10.02.2021, si dhe Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë deri në 18.10.2021 dhe Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë deri në datën 08.03.2023. **Shuma 6.258.832.**

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, punëdhënësit: Drejtoria Vendore e Policisë Berat që konfirmon se z. Fatmir Hoxha ka realizuar të ardhurat mbi bazën e të cilave është derdhur kontribut si vijon:
  - Për periudhën mars 1990 - dhjetor 1990, të ardhura nga paga neto janë në shumën **5.440 lekë**.
  - Për periudhën janar 1991 - dhjetor 1991, të ardhurat nga paga neto janë në shumën **12.568 lekë**.
  - Për periudhën mars 1998 - dhjetor 1998, të ardhurat nga paga neto janë në shumën **133.931 lekë**.
  - Për periudhën janar 1999 - shkurt 1999, të ardhurat nga paga neto janë në shumën **22.510 lekë**.
  
- Vërtetim me nr.18 prot që konfirmon se z.Fatmir Hoxha, ish-punonjës në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier ka realizuar këto të ardhura:
  - Për periudhën 01.05.1990 -31.12.1991, nuk disponojnë pagesa.
  - Për periudhën 01.01.1992 deri më 16.03.1998, të ardhurat nga paga dhe shpërblimet janë në shumën neto 508.236 lekë.
  
- Vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 12.04.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, Komisariati i Policisë Sarandë, që konfirmon se z.Fatmir Hoxha ka qenë punonjës i policisë pranë Komisarariatit të Policisë Delvinë, për periudhën 16.02.1999 deri më 01.10.1999 dhe për këtë periudhë ka përfituar të ardhura page dhe shpërblime në vlerën 120.249 lekë.
  
- Vërtetim me nr \*\*\*\*\* prot., datë 17.04.2018, nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, konfirmon se z. Fatmir Hoxha ish-punonjës i policisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë ka realizuar të ardhura nga paga neto si vijon:
  - Për periudhën 01.10.1999 deri në 31.07.2000, në shumën 170.622 lekë (Komisariati i Policisë Pogradec)
  - Për periudhën 01.08.2000 deri më 16.05.2001, në shumën 210.094 lekë (Komisariati i Policisë Kolonjë)
  - Për periudhën 16.05.2001 deri më 01.03.2003, në shumën 797.506 lekë (Komisariati i Policisë Kolonjë)
  
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, konfirmon se z. Fatmir Hoxha, për periudhën 01.03.2003 deri më 30.04.2005, ka realizuar të ardhur mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi si me poshtë vijon:
  - Për periudhën mars 2003 - dhjetor 2003, të ardhurat nga paga neto janë në shumën 581.684 lekë.
  - Për periudhën janar 2004 - dhjetor 2004, të ardhurat nga paga neto janë në shumën 708.288 lekë.
  - Për periudhën janar 2005 - dhjetor 2005, të ardhurat nga paga neto janë në shumën 36.096 lekë.

**Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit.**

- + **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 08.05.2023, përcjell CD që konfirmon se Fatmir Hoxha ka llogari page dhe për periudhën 04.05.2005 - 07.07.2009, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga paga, shërbimi dhe dietat, në shumën rreth 2.917.954 lekë, ndërsa në periudhën 02.07.2021 - 03.03.2023, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga paga, shpërblime rreth 2.572.808 lekë.
- + **Banka Kombëtare Tregëtare**, me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 09.05.2003, konfirmon se Fatmir Hoxha ka pasur llogari bankare dhe për periudhën 31.01.2013 - 08.04.2013, i janë kredituar në llogari të ardhurat neto nga paga, nga Certified Solution Corporation Shpk, në shumën rreth 160.000 lekë.
- + **Tirana Bank**, me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Fatmir Hoxha ka llogari page dhe për periudhën 04.03.2014 - 03.06.2021, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga paga, shpërblime, dieta nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria Rajonale Policia Gjirokastrë, në shumën rreth 9.389.377 lekë.
- + **Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 09.05.2023, i ka dërguar shkresë Drejtorisë së Arkivit në Lundër, për të konfirmuar të ardhurat e realizuara nga shtetasi Fatmir Resmi Hoxha dhe familjarët e tij, për periudhën para viti 2012.
- + **Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Arkivit Qendror**, me shkresën kthim - përgjigje me nr.\*\*\*\* prot., datë 16.05.2023, nuk konfirmon të dhëna për periudhën 1994 - 2012, për shtetasin Fatmir Resmi Hoxha dhe familjarët e tij bashkëlidhur si vijon:

- Vërtetim për vjetërsi në punë për efekt pensioni, me nr.\*\*\* prot., datë 12.05.2023, që konfirmon se shtetasi Fatmir Resmi Hoxha, figuron i regjistruar në Rajonin Gjirokastrë dhe ka punuar në Ndërmarrjen Bujqësore, Tepelenë për periudhën 11.09.1980 - 28.08.1981.

37. Në proces-verbalin e datës 30.06.2023, mbajtur pranë ILDKPKI-së, dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit, subjekti sqaron se:

- *“nga muaji gusht 2007 deri në muajin shkurt 2014, ka qenë i larguar nga puna në Policinë e Shtetit, për shkak shkurtimi të funksionit organik. Për periudhën e viteve 2007-2009 ka marrë pagesat nga reforma. Për të ardhurat e konstatuara nga BKT, për periudhën 31.01.2013-08.04.2013 në shumën 160.000 lekë nga Certified Solution Corporation Shpk”, sqaroi se ka punuar pranë kësaj shoqërie e cila kishte si veprimtari prodhim mobiljesh dhe ishin pagesat që ja ka kaluar kjo kompani.*

Subjekti i vlerësimit paraqiti dokumentacion bashkëlidhës:

- Vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2020, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, vërteton se Fatmir Hoxha është trajtuar me pension sipas ligjit nr. 10142, datë 15.01.2009, i ndryshuar, për pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

- Librezë me nr. \*\*\* datë 01.07.2009, për përfitim suplementar të ushtarakut në emër të Fatmir Resmi Hoxha.

**37.1 Trupa e vlerësimit referuar kthim-përgjigjeve të institucioneve ligjzbatuese dhe bankave të nivelit të dytë konstaton përputhshmëri të deklarimit të subjektit mbi vlerat e përfitimit të të ardhurave ndër vite nga marrëdhënia e punës.**

### A/3 Shpenzimet e deklarueshme

❖ **Të viti të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit të vlerësimit ose personave të lidhur me të. Periudha 01.01.2022-31.12.2022**

- Shpenzime energjie elektike për vitin e fundit kalendarik, janar - dhjetor 2022, janë 50.755 lekë.
- Shpenzime ujësjellësi për vitin kalendarik, janar - dhjetor 2022 janë 26.236 lekë.
- Shpenzime për telefon celular, telefon fiks dhe internet për vitin janar - dhjetor 2022 janë 70.800 lekë (unë, bashkëshortja dhe dy vajzat).

Shpenzimet në total janë në shumën 147.790 lekë.

✚ **FSHU**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.05.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Fatmir Resmi Hoxha, për periudhën deri në datën 08.03.2023, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë furnizimi me energji elektrike.

- Me gjeneralitetet Fatmir Hoxha, për periudhën deri në datë 08.03.2023, referuar të dhënave të sistemit të faturimit identifikohen 159 abonentë me kontratë furnizimi me energji elektrike në instancat: Tiranë, Shkodër, Kukës, Pogradec, Burrel, Shijak, Vlorë, Berat, Kavajë, Sarandë, Gjirokastër, Durrës, Fier, Lushnjë, Korçë, Elbasan.
- Me gjeneralitetet Merita Hysen Hoxha, për periudhën deri në datën 08.03.2023, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë furnizimi me energji elektrike.
- Me gjeneralitetet Eden Fatmir Hoxha, për periudhën deri në datën 08.03.2023, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë furnizimi me energji elektrike.
- Me gjeneralitetet Fjona Fatmir Hoxha, për periudhën deri në datën 08.03.2023, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë furnizimi me energji elektrike.

**38. Në proces-verbalin e datës 30.06.2023, mbajtur pranë ILDKPKI-së, dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se, ka lidhur kontratë furnizimi me energji elektrike me nr C-\*\*\*\*, vetëm për apartamentin e banimit me sip. 87 m<sup>2</sup>, në rrugën “Vaçe Zela”, ndërsa për garazhin që ka në pronësi nuk ka lidhur kontratë për furnizimin me energji elektrike, pasi ky ambient nuk është funksional.**



- “Për konkluzionin nga FSHU, deklaroj në përgjegjësi personale se Fatmir Resmi Hoxha me nr. ID G\*\*\*\*\*E dhe Merita Hysen Hoxha me nr ID G\*\*\*\*\*C, nuk kanë lidhur kontrata të tjera me FSHU dhe se duhet të jenë shtetas të tjerë, me gjeneralitete të ngjashme.

Dokumentacioni që dorëzoi subjekti:

- Librezën e energjisë elektrike me nr. C-\*\*\*\*, në emrin Fatmiri Hoxha që konfirmon shpenzimet për energjinë ekektrike, për vitin 2022, ishin në shumën 50.358 lekë.

### **Konkluzion:**

38.1 Trupa e vlerësimit konstaton se, për faktet e sipërpërmendura, në lidhje me numërin e madh të abonentëve me gjeneralitetet Fatmir Hoxha, **nuk provohet fakti se këta abonent janë me gjeneralitetet e plota**, si subjekti i vlerësimit Fatmir Resmi Hoxha, pasi nuk provohet as atësia dhe as numëri i identifikimit.

✚ **Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Tirana sh.a**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.05.2023, konfirmon se në emër të z. Fatmir Hoxha rezultojnë 15 kontrata me status aktiv, në kategorinë e konsumatorit familjar, por nga kontrolli në arkivën e Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a, **nuk disponojnë asnjë dokumentacion** që të vërtetoj se shtetasi Famir Hoxha, që rezulton në kontratat e mësipërme, ka të njëjtat gjeneralitete, me subjektin e vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha me nr. ID G\*\*\*\*\*E.

- Në emër të Merita Hoxha rezultojnë 2 kontrata me status aktiv, në kategorinë e konsumatorit familjar, por nga kontrolli në arkivën e UK Tirana sh.a, **nuk disponojnë asnjë dokumentacion**, që të vërtetoj se shtetasja Merita Hoxha, që rezulton në kontratat e sipërcituara ka të njëjtat gjeneralitete me Merita Hysen Hoxha me nr. ID G\*\*\*\*\*C.
- Për shtetasit: Eden Fatmir Hoxha dhe Fjona Fatmir Hoxha nuk rezulton asnjë e dhënë, për Kontrata për Shërbime me Ujësjellës Kanalizimet Tiranë sh.a, të regjistruar në sistem në emër të tyre.

✚ **Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.05.2023, konfirmon se në emër të Fatmir Hoxha, ekzistojnë 3 kontrata por pa atësi dhe pa gjeneralitete në sistemin AI - Billing.

- Shtetaset: Merita Hysen Hoxha, Eden Fatmir Hoxha, Fjona Fatmir Hoxha, nuk rezultojnë të regjistruar në sistem.

✚ **Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.05.2023, konfirmon se 2 shtetas me emrin Fatmir Hoxha, kanë lidhur kontrata.

✚ **Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.05.2023, konfirmon se me emrin Fatmiri Hoxha, ekzistojnë 21 kontrata, për të cilat nuk disponohen të dhëna në lidhje me gjeneralitetet, për të saktësuar nëse bëhet fjalë për të njëjtin shtetas, si dhe nuk disponojnë një kopje të kontratave.

- Shtetaset: Merita Hysen Hoxha, Eden Fatmir Hoxha dhe Fjona Fatmir Hoxha nuk figurojnë abonent.
- ✚ **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 05.05.2023, konfirmon se në sistemi AL-Billing, rezultojnë 9 kontrata me emrin Fatmir Hoxha ku nuk disponohet karta ID.
  - Shtetaset: Merita Hysen Hoxha, Eden Fatmir Hoxha dhe Fjona Fatmir Hoxha nuk figurojnë abonent.
- ✚ **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a**, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 24.05.2023, konfirmon se në emër të Fatmir Hoxha (pa atësi) rezulton një kontratë me status aktiv, në kategorinë e konsumatoreve familjar. Nuk konfirmohet nëse është i njëjti me subjektin e vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha me nr. ID G\*\*\*\*\*E, pasi nuk disponojnë kontratë shkresore.
- ✚ **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh.a**, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 15.06.2023, konfirmon se në emër të Fatmir Hoxha, (pa atësi dhe ID) rezultojnë 3 kontrata.
  - Shtetaset: Merita Hysen Hoxha, Eden Fatmir dhe Fjona Fatmir Hoxha nuk rezultojnë të kenë kontrata në emër të tyre.
- ✚ **7 Shoqëri Rajonale të Ujësjetllës Kanalizime**, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

**Konkluzion:**

39. **Trupa e vlerësimit konstaton** se për faktet e sipërpërmendura, në lidhje me numërin e madh të abonentëve me gjeneralitetet Fatmir Hoxha, **nuk provohet fakti se këta abonent janë me gjeneralitetet e plota**, si subjekti i vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha, pasi nuk provohet as atësia dhe as numëri i identifikimit.
- ✚ **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës kanalizime Gjirokastër sh.a** me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 19.05.2023, konfirmon se **Fatmir Resmi Hoxha, nr. ID G\*\*\*\*\*E ka 1 kontratë me Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër sh.a**, me nr. kontrate \*\*\*\*\*, në Përmet. Për periudhën janar-dhjetor 2022 ka paguar vlerën totale 10.214,67 lekë. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizimet Gjirokastër, nuk disponojnë kontrata me shtetaset Merita Hysen Hoxha, Eden Fatmir Hoxha dhe Fjona Fatmir Hoxha.
40. **Në proces-verbalin e datës 30.06.2023**, subjekti sqaroi se ka lidhur kontratë furnizimi për ujin, vetëm për apartamentin e banimit me sip. 87 m<sup>2</sup>, Tiranë, ndërsa për garazhin që ka në pronësi nuk ka lidhur kontratë për furnizimin e ujit.
- *“Lidhur me konkluzionet nga Ujësjetllës Kanalizimet Gjirokastër, deklaroj në përgjegjësi personale, se nuk ka lidhur kontratë me Ujësjetllës Kanalizimet Gjirokastër, pasi nuk ka pasuri të regjistruar në qytetin e Përmetit dhe duhet të jetë përgjegjë e gabuar e institucionit”.*

- Subjekti paraqiti librezë ujë me nr.\*\*\*\*, mbi bazën e të cilës janë llogaritur shpenzimet, për ujin për vitin 2022 në shumën 26.193 lekë.

**40.1 Në lidhje me konkluzionin e Shoqërisë së Ujësijellës Kanalizimeve Gjirokastrë sh.a, trupa e vlerësimit zhvilloi hetim te mëtejshëm për të shtruar çdo paqartësi e më konkretisht:**

✚ **ASHK Drejtoria Rajonale Përmet**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 06.07.2023, nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të z. Fatmir Resmi Hoxha, dhe familjarëve të tij.

40.2 **Agjencia e Mbikëqyrjes Policiore**, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 07.09.2023, drejtuar Shoqërisë Rajonale të Ujësijellës Kanalizime Gjirokastrë, kërkoi informacion mbi kontratën e lidhur dhe identitetin e konsumatorit, ku me kthim-përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 25.09.2023, konstatojnë se nga verifikimi i kryer në sistemin e faturimit, z. Fatmir Hoxha që ka lidhur kontratën e ujësijellës është një person tjetër me ID të ndryshme, nga subjekti i vlerësimit.

40.3 Në lidhje me paqartësinë e krijuar nga përmbajtja e dy shkresave ‘kthim-përgjigje’ të Ujësijellës Kanalizimeve Gjirokastrë, që mbajnë nr.\*\*\* prot., datë 19.05.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 25.09.2023, trupa e vlerësimit kërkoi një verifikim më të detajuar nga Shoqëria Rajonale e Ujësijellës Kanalizimeve Gjirokastrë, ku me shkresën nr. datë 18.10.2023 u konfirmoi se *“nga verifikimet e kryera në sistemin tonë rezultoi vetëm një abonent në njësinë Përmet, me emrin Fatmir Hoxha me nr. ID G\*\*\*\*\*H dhe me kod kontrate \*\*\*\*\*”* **nga ku rezultoi se ky abonent nuk është subjekti i vlerësimit Fatmir Resmi Hoxha.**

**Konkluzion:**

40.4 **Trupa e vlerësimit konstaton se, nga të dhënat e faktit në lidhje me kthim - përgjigjet e Ujësijellës Kanalizimeve Gjirokastrë, konstatohet se abonenti që i referohen kthim - përgjigjet e korrespondencës nuk rezultoi të jetë subjekti i vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha.**

✚ **Vodafone Albania Sh.a**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.06.2023, përcjell CD ku konfirmon se:

- Fatmir Hoxha ka regjistruar 1(një) numër celulari, nga data 13.02.2014, me status aktiv dhe për vitin 2022, rezultojnë pagesat në shumën 6.132 lekë;
- Merita Hoxha ka të regjistruar 1(një) numër celulari, nga data 26.12.2019, me status aktiv dhe për vitin 2022, rezultojnë pagesat në shumën 11.230 lekë;
- Eden Hoxha ka pasur të regjistruar 1 (një) numër celulari, nga data 01.11.2017, i cili ka kaluar në status inaktiv, në datën 02.02.2019;
- Fjona Hoxha ka të regjistruar 1(një) numër celulari, nga data 12.02.2020 dhe për vitin 2022 rezultojnë pagesa në shumën 15.517 lekë.

✚ **One Albani Sh.a**, me shkresën nr \*\*\* prot., datë 07.06.2023, përcjell CD, ku konfirmon se Fatmir Resmi Hoxha, nr. ID G\*\*\*\*\*E, rezultoi i regjistruar me numer fix ONE Albania. Totali i

faturave nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022 është 26.400 lekë me tvsh. Totali i pagesave që është bërë është 21.600 lekë.

- ✚ **Albania Satellite Communications shpk**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti vlerësimit dhe personat e lidhur me të.
- ✚ **Abissnet Sh.a**, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 01.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti vlerësimit dhe personat e lidhur me të.
- ✚ **Digicom Sh.a**, me shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.05.2023, konfirmon se z. Fatmir Resmi Hoxha dhe personat e lidhur me të nuk kanë marrë shërbim interneti nga shoqëria Digicom, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

### ***Konkluzion:***

**40.5 Trupa e vlerësimit konstaton përputhshmëri të deklaramit të subjektit, për rubrikën e shpenzimeve të formularit të deklaramit me dokumentacionin e administruar.**

### ***A/4 Udhëtimet e tre viteve të fundit***

❖ **Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike) duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara – Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.**

- Shpenzime udhëtimi për tre vite kalendarike:
  1. Për vitin 2020 vetëm një natë, në datën 24.10.2020, për në Kosovë, me familje, dalë nga pika kufitare Morinë, shpenzuar 200 euro.
  2. Shpenzuar për vitin 2022 në datën 23.04.2022, për një natë dalë me bashkëshorten dhe dy vajzat nga Pika Kufitare Kapshticë, shpenzuar 300 euro.
  3. Gjithashtu për pushimet e verës kam dalë me familjen në datën 24.07.2022, nga pika kufitare Kakavijë, deri në datën 30.07.2022, kemi shpenzuar në total vlerën 3.000 euro.
  4. Kam kryer udhëtime për arsye pune brenda ditës në datat 15.03.2022, në Maqedoni (takim rajonal me ndërmjetësim OSBE), në 06.07.2022 në Maqedoni (takim rajonal me ndërmjetësim OSBE) dhe në 11.10.2022, në Kakavijë (takim me palën greke) kostoja e shpenzimeve 0 lekë.
- Vajza e madhe Eden Hoxha, ka kryer udhëtime të shpeshta, nga Komisariati i Policisë Rinas, për arsye pune, ku të gjitha pagesat janë kryer nga kompania ku është e punësuar.

**Shpenzimet në total janë në shumën 3.500 euro.**

41. Në proces-verbalin e datës 30.06.2023, subjekti sqaroi se udhëtimet private të deklaruara ishin kryesisht udhëtime 1 ditore për vizita turistike, për të cilat nuk kishte ruajtur fatura shpenzimesh. Në periudhat nga data 24.7.2022 deri në datë 30.07.2022, sqaroi se ishte familjarisht me pushime. Nuk

disponon dokumeta vërtetues, pasi këto shpenzime përfshijnë pagesën e shtëpisë, për të cilën pronari nuk lëshonte faturë pagese dhe pjesa tjetër e shpenzimeve ishte për ushqim etj. Paraqiti:

- Dokumentacion nga sistemi TIMS që vërteton daljet jashtë territorit të Shqipërisë.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar përsa i përket hyrje - daljeve nga Republika e Shqipërisë gjatë periudhave 2020 - 2022, të subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

41.1 Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës së sipërcituar rezultojnë në total rreth 3.500 euro, e konvertuar në shumën rreth 402.000 lekë<sup>6</sup>. Ku referuar tabelës financiare konstaton se subjekti i vlerësimit ka pasur të ardhura për të mbuluar shpenzimet e udhëtimeve të tre viteve të fundit.

#### A/5 Arsimi.

❖ **Për arsimin e fëmijëve, madhor apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimi, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore si dhe kohëzgjatjen e studimeve sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32 të ligjit të vlerësimit.**

- Shpenzime për arsimin e vajzës, Eden Hoxha në Fakultetin e Mjekësisë, Dega Farmaci për periudhën 2011-2016, në vlerën 160.000 lekë.
- Shpenzime për arsimin e vajzës, Fjona Hoxha në Fakultetin Juridik, për periudhën 2013-2017, në vlerën 261.000 lekë.

**Shpenzimet totale në vlerën 421.000 lekë.**

42. Në proces-verbalin e datës 30.06.2023, subjekti i vlerësimit sqaroi se: *“shpenzimet e deklaruara për arsimin e vajzave Eden Hoxha në Fakultetin e Mjekësisë, Dega Farmaci për periudhën 2011-2016, në vlerën 160.000 lekë, si dhe shpenzime për arsimin e vajzës Fjona Hoxha në Fakultetin Juridik, për periudhën 2013-2017, në vlerën 261.000 lekë, janë sipas tarifave fikse të vendosura për fakultetet përkatëse dhe lidhur me këto shpenzime nuk ka ruajtur fatura pagesash”*. Paraqiti:

- Diplomë Master në Fakultetin e Mjekësisë, Dega Farmaci, për arsimin e Eden Fatmir Hoxha.
- Diplomë Bachelor në Drejtësi, për arsimin e Fjona Fatmir Hoxha.

42.1 Shpenzimet e deklaruara për arsimin e vajzës, gjatë periudhës deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, rezulton në total rreth 421.000 lekë. Ku referuar tabelës financiare konstaton se subjekti i vlerësimit ka pasur të ardhura për të mbuluar arsimin e personave të lidhur.

#### **A/7 DEKLARIMI I PERSONIT TË LIDHUR BASHKËSHORTES MERITA HOXHA**

##### **Pasuria nr.1**

<sup>6</sup> Referuar kursit të kembimit të vitit 2020-2022 për datat specifike të udhëtimit.

- ❖ Llogari bankare për pagat në Raiffeisen Bank, me numer llogarie \*\*\*\*\*, gjendje në 07.03.2023, në vlerën 1.557.294 lekë. **Burimi i krijimit:** të ardhura nga paga si e punësuar pranë “Delta Pharma-Al”. Vlera 1.557.294 lekë. Zotëron 100%.

### **Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit:**

43. **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Merita Hoxha, ka llogari page me gjendje në datën 08.03.2023, në shumën 1.557.294 lekë. Pasuria është krijuar gjatë periudhës 2019 - 2023.

### ***Konkluzion:***

44. Konfirmohet deklarami me dokumentacion e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank, me burim krijimi të ardhura nga paga. Trupa e vlerësimit ka kryer hetimin mbi mundësinë e krijimit të pasurisë së mësipërme. Hetimi konsiston në realizimin e analizës financiare, *(të ardhura - shpenzime)* mbi mundësinë e kurimit të pasqyruar, *(bashkëlidhur relacionit si shtojcë nr.1)*, **nga ku rezulton se personi i lidhur ka mundësi për krijimin e kësaj pasurie.**

- ❖ **Në në kuadër të vlerësimit të pasurisë referuar ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, trupa e vlerësimit dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, kanë realizuar hetim kryesisht, duke kërkuar informacione për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur me të:**

45. Nga verifikimet e kryera nga trupa e vlerësimit në korrespondencën e përcjellë ndërmjet ILDKPKI-së dhe bankave të nivelit të dytë **nga Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.05.2023, u konfirmua se shtetasja S. Levanaj dhe Merita Hoxha, në datën 10.12.2021 kanë hapur depozitë në lekë me afat 12 mujor, me urdhër xhirimi nga S. Levanaj, në shumën 2.752.192 lekë. Gjendja në datën 08.03.2023 është në shumën **2.752.192 lekë.**

Gjithashtu **Credins Bank konfirmon se**, shtetasja S. Levanaj dhe Merita Hoxha në datën 10.12.2021 kanë hapur depozitën në cad, me afat 12 mujor, me urdhër xhirimi nga shtetasja S. Levanaj, në shumën 10.230 cad. Gjendja në datën 08.03.2023, është në shumën **10.230 cad.**

- **Një deklarami i tillë nuk është pasqyruar në deklaratën e personit të lidhur.**

- 45.1 Për një hetim të plotë e të bazuar në ligj dhe në prova trupa e vlerësimit, verifikoi dhe arsyetoi të gjitha fakte, rrethanat dhe thëniet e vet subjektit të deklaramit si më poshtë vijon:

46. **Credins Bank**, me e-mail e datës 17.07.2023, konfirmon se vlerat 2.752.192 lekë dhe 10.230 cad kanë qenë gjendje në depozitat personale të S. Levanaj dhe në datën 10.12.2021, janë xhiruar në depozita dy emërore, në emrin e shtetasës S. Levanaj dhe Merita Hoxha.

Nga verifikimi i dokumentacionit verifikohet urdhër xhirimi i datës 10.12.2021, të kryer nga shtetasja S. Levanaj dhe krijimi i depozitave 2 emërore.

46.1 **Në proces-verbalin e datës 30.06.2023, të mbajtur pranë ILDKPKI** dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit në lidhje me depozitat 2 emërore, subjekti sqaroi se:

- *“shtetasja S. Levanaj është nëna e bashkëshortes Merita Hoxha. Ajo jeton dhe është rezidente në Kanada dhe të gjitha shumat e depozituara në Credins Bank, janë kurismet nga puna e saj dhe pensioni në Kanada si dhe pensioni i pleqërisë që ajo përfiton në Shqipëri nga viti 2013. Për lehtësi veprimesh ka autorizuar vajzën Merita Hoxhën, për të kryer veprimet dhe për të menaxhaur likuiditetet në bankë. Deklaroj se bashkëshortja Merita Hoxha nuk ka asnjë pjesë takuese në këto depozita”.*

Subjekti i vlerësimit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Vërtetim i datës 26.03.2023, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që konfirmon se S. Levanaj ka përfituar pension pleqërie në Shqipëri, nga data 01.05.2013 e në vazhdim, në masën mujore rreth 23.591 lekë.
- Raport personi datë 13.06.2023, që konfirmon hyrjet dhe daljet në territorin e Republikës së Shqipërisë, për shtetasen S. Levanaj për periudhën 2007 - 2017.
- Dokumentacion nga shteti Kanadez, që konfirmojnë të ardhurat e përfituara nga shtetasi H. Levanaj dhe S. Levanaj, nga viti 2008 - 2022, në Kanada, në shumën rreth 851.458 cad.
- Dokumentacion bankar, datë 13.06.2023, nga Credins Bank, për depozitat 2(dy) emërore në emrin e S. Levanaj dhe Merita Hoxha të cilat janë hapur me urdhër xhirimi nga shtetasja S. Levanaj.
- Deklaratë personale të bashkëshortes Merita Hoxha në të cilën pasqyrohen raportet e saj në lidhje me depozitat 2 emërore në Credins Bank.

46.2 Relatorja e çështjes i është drejtuar subjektin të vlerësimit më e-mail-in e datës 25.10.2023, për të dhënë shpjegime në lidhje me mungesën e pasqyrimin të këtyre depozitave të personit të tij të lidhur në deklaratën e vlerësimit të pasurisë **me nr. index 1 datë 08.03.2023**, ku referuar nenit 32 të ligjit të vlerësimit ka detyrimin ta deklarojë. Në kthim-përgjigjen që mban nr. \*\*\*prot., datë 01.11.2023 subjekti i vlerësimit ka sqaruar se:

- *“Merita Hoxha dhe S. Levanaj kanë lidhje bijë nënë. S. Levanaj jeton në Kanada. Të gjitha këto shuma janë depozita të S. Levanaj, nënës së Meritës duke qene se ajo banon në Kanada, për lehtësi veprimesh bankare në favor të S. Levanaj ka autorizuar Meritën për të kryer keto veprimet. Merita nuk ka asnjë pjesë takuese të këtyre depozitave.*

#### **Konkluzion:**

46.3 Trupa e vlerësimit nga gërshetimi i të dhënave të faktit, dokumentacionit të siguruar nga subjekti i vlerësimit konstaton se znj. S. Levanaj **ka burime të mjaftueshme ligjore për të krijuar këto pasuri.**

46.4 Trupa e vlerësimit konstaton se subjekti i vlerësimit, pasqyron argumenta bindës dhe dokumentacion mbi burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre depozitave nga ana e personit të lidhur bashkëshortes, si dhe është verifikuar fakti që nuk ka kontribuar në krijimin e kësaj pasurie me mjete



financiare. Fakti i mospasqyrimit në deklaratën e vlerësimit të pasurisë, ka qenë një keqkuptim i dispozitave të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

- ✚ **OTP Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 05.05.2023, konfirmon se Merita Hoxha ka llogari page, me gjendje në datën 08.03.2023, me shumën 74.925 lekë.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, konfirmon se Merita Hoxha ka llogari për tërheqje në Master Card në lekë, e hapur në datën 17.04.2013, me limit 35.000 lekë. Gjendja në datën 08.03.2023 është në shumën 92 lekë.
- ✚ **Credins Invest**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023 konfirmon se Merita Hoxha, është kliente prej datës 16.04.2015, në Fondin e Pensionit “*Credins Pension*”. Gjendja në datën 08.07.2023 është:
  - a. kuota -4.1067
  - b. balanca -6.695 lekë.

47. Trupa e vlerësimit konstaton se, në deklaratën e pasurisë së personit të lidhur bashkëshortes së subjektit të vlerësimit janë konstatuar mospasqyrime të llogarive bankare, të cilat në datën 07.03.2023 kanë qenë aktive.

#### **Konkluzion:**

47.1 **Trupa e vlerësimit, duke marrë në konsideratë rrethanat e faktit, në referim të shterimit të hetimit arrin në përfundimin se këto veprim kanë qenë jo të qëllimshëm, nga ana e personit të lidhur me subjektin e vlerësimit. Ky veprim ka ardhur si rezultat i moskryerjes së veprimeve nga ana e personit të lidhur, për një kohë të gjatë mbi këtë llogari.**

❖ **Në zbatim të nenit 32 të ligjit 12/2018, i ndryshuar, “...subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të deklarojnë çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar, nga data e fillimit të punës në institucionin...”** gjatë hetimit të kryer mbi verifikimin e deklarimeve të pasurisë nga:

✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.05.2023, ka konfirmuar se znj. Merita Hoxha ka pasur depozitë në cad, me afat 1 mujor dhe në datën 06.08.2012, i është transferuar në llogari me urdhër xhirimi, nga shtetasja S. D, shuma 13.926 cad. Në datën 07.09.2012 dhe 20.11.2012, Merita Hoxha ka tërhequr respektivisht shumat 6.000 cad dhe 7.945 cad dhe e ka mbyllur depozitën.

✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 15.05.2023, gjithashtu ka konfirmuar se Merita Hoxha, ka pasur llogari rrjedhëse në cad dhe në datën 12.05.2015 i është transferuar në llogari nga banka të tjera nga shtetasja S. Levanaj, shuma 14.956 cad. Në datën 12.05.2015, Merita Hoxha ka konvertuar shumën 14.956 cad, në shumën 1.542.124 lekë dhe e ka transferuar këtë shumë në logarinë e shtetases S.D.

48. **Në proces-verbalin e datës 30.06.2023, e mbajtur pranë ILDKPLI-së,** dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, në lidhje me derdhjet që janë bërë në emër të shtetases S. D subjekti i vlerësimit sqaroi se:

➤ *“bashkëshortja Merita Hoxha këtë shtetase e ka nusen e nipit (djalit të vëllait) dhe këto likuiditete janë tërhequr nga llogaria e nënës S. Levajan me miratimin e saj. Sqaroi se këto vlera likuiditetesh janë dërguar nga S. Levana, për garanci për dokumentat kanadeze që po përgatiste nusja e nipit S. D. Deklaroi se këto likuiditete kanë si burim të ardhurat e nënës së bashkëshortes dhe në këtë rast bashkëshortja e subjektit ka kryer vetëm transfertat bankare”.*

- Subjekti i vlerësimit paraqiti certifikatë familjare, datë 13.6.2023, të shtetasve E. Levana dhe shtetasja S. D.

48.1 Gjithashtu me kthim-përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 01.11.2023, subjekti i vlerësimit u shpreh se:

➤ *“Përsa i përket derdhjeve që janë berë në emer të shtetasës S. D, Merita e ka nusen e nipit (djalit të vëllait) këto janë lekë të tërhequra nga llogaria e shtetasës S. Levana. Ku S. Levana, ja dërgoi për garanci për dokumentat kanadeze që po bente shtetasja S. D. Merita thjesht ka kryer transfertat bankare të autorizuara nga nëna e saj S. Levana”*

#### **Konkluzion:**

48.2 **Trupa e vlerësimit në zbatim të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar**, në përfundim të analizimit dhe vlerësimit të deklarimit të subjektit, dokumentacionit justifikues, të dhënave të mbledhura nga institucionet ligjzbatuese, **konstaton se në lidhje me transfertën e mësipërme të konfirmuar nga Credins Bank, me shkresën e datës nr. \*\* prot., datë 15.05.2023, znj. S. Levana ka pasur mundësi krijimi të vlerës prej 14.956 cad, transferuar në llogari të znj. Merita Hoxha dhe më pas nga kjo e fundit në llogari të znj. S. D.**

✚ **Raiffeisen Bank**, konfirmon se Merita Hoxha në datën 11.12.2007, i është disbursuar kredi në shumën 300.000 lekë, në datën 17.06.2008 ka derdhur në llogari shumën 295.400 lekë dhe ka mbyllur kredinë.

49. Subjekti i vlerësimit në proces - verbalin e datës 30.06.2023, deklaroi se shuma prej 300.00 lekësh është marrë nga bashkëshortja, për blerje pajisjesh elektroshtëpiake dhe më pas në datën 17.06.2008, ka derdhur në llogari shumën 295.400 lekë dhe ka mbyllur kredinë.

Referuar hetimit në mbështetje të ligjit nr. 12/2018. i ndryshuar, në lidhje me derdhjen në llogari të shumës 295.400 lekë, i pyetur nga relatorja e çështjes me e-mailin e datës 27.09.2023, mbi burimin e krijimit të të ardhurave të personit të lidhur me vlerën 295.400 lekë.

Subjekti deklaroi se:

➤ *“bashkëshortja ime Merita Hoxha, ka shlyer kredinë në datën 17.06.2008, me burimin e të ardhurave nga punësimi pranë “Delta Pharma-Al” e punësuar që nga viti 2005”.*

#### **Konkluzion:**

49.1 Trupa e vlerësimit referuar përgjigjeve të subjektit të vlerësimit, si dhe bazuar në tabelën financiare të të ardhura shpenzimeve, konstaton se balanca e vitit 2008, del pozitive me mundësi për të shlyer kredinë.

✚ **Raiffeisen Invest**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Merita Hoxha ka pasur marrëdhënie juridike me Raiffeisen Invest sh.a, duke investuar në Fondin e Raiffeisen Prestige, që ka filluar në datën 10.06.2013 dhe ka përfunduar në datën 17.09.2013. Vlera e investimit shuma 200.000 lekë. Në datën 20.09.2013, i është transferuar në llogari nga Raiffeisen Invest, shuma 203.964 lekë, me përshkrimin : “*shlyerje sipas urdhërit*”.

- Në datën 27.06.2014 i është disbursuar kredi në shumën 75.000 lekë, e cila rezuton e mbyllur në datën 02.06.2015.

✚ **AK Invest**, deklaron se shtetasja Merita Hoxha ka kryer transaksion si përfituese nga shteti kanadez vlerën prej 600 cad e konvertuar në 47.224 lekë, në datën 17.12.2018, me dërgues shtetasin S. Levanaj.

- *Subjekti sqaroi se bashkëshortes, në datën 17.12.2018 i ka dërguar vëllai i saj shumën prej 600 cad, me qëllim dhuratë për vajzat.*

50. **Trupa e vlerësimit ka konfirmuar marrëdhënien e znj. Merita Hoxha dhe S. Levanaj, marrëdhënie familjare që justifikon edhe faktin e dërgimit të shumës prej 600 cad.**

✚ **Qendra Kombëtare e Biznesit**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon se për periudhën deri në datën 08.03.2023, shtetasja me gjeneralitete Merita Hoxha (data, muaji, viti lindjes nuk mund të verifikohen), figuron e regjistruar si person fizik, me vendimin nr. 21 datë 27.06.1991 të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Sa më sipër nuk mund të identifikohet Nipt-i me të cilin është regjistruar kjo shtetase. (*Bashkëlidhur vendimi i gjykatës*)

51. **Trupa e vlerësimit** ka shteruar hetimin në lidhje me konkluzionin e mësipërm duke ju drejtuar institucionit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, ku me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 02.06.2023, është konfirmuar se shtetasja Merita Hysen Hoxha me nr. ID G\*\*\*\*\*C, nuk është e regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Dibër.

**Konkluzion:**

52.1 **Nga verifikimi i trupës së vlerësimit nuk konfirmohet që znj. Merita Hysen Hoxha të jetë e regjistruar si person fizik për ushtrim veprimtarie.**

### **A/8 DEKLARIMI I TË ARDHURAVE TË PERSONIT TË LIDHUR BASHKËSHORTES MERITA HOXHA**

- Të ardhura nga paga si sekretare, Policia Hetimore Fier për një vit, në vitin 1992, gjithashtu e punësuar për 8 muaj si mësuese në gjimnazin e Fierit në vitin 1993. Në vitin 1994 me asistencë për dy vit deri në vitin 1996. Të ardhurat si ekonomiste në sektorin privat, nga periudha 1996 -

1998. Të ardhurat nga përfitimi i transferimit të bashkëshortit për arsye pune nga periudha 1998 - 2003. **Shuma 660.590 lekë.**

- Të ardhurat si e punësuar pranë “Delta Pharma-Al” nga periudha 2005 deri në janar 2023. **Shuma 8.027.022 lekë.**

- **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare me nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2020, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Arkivit Qendror që konfirmon se znj. Merita Hoxha për periudhën nëntor 2006 - dhjetor 2009, ka realizuar këto të ardhura mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi, në subjektin “Delta Pharma-Al”, me nr. dosje \*\*\*\*, si vijon:

1. Për periudhën dhjetor 2006, të ardhura nga paga në shumën 15.000 lekë.
2. Për periudhën janar 2007 - dhjetor 2007, të ardhura nga paga në shumën 216.600 lekë.
3. Për periudhën janar 2008 - dhjetor 2008, të ardhura nga paga në shumën 204.000 lekë.
4. Për periudhën janar 2009 - dhjetor 2009, të ardhura nga paga në shumën 212.000 lekë.

- Vërtetimi për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare me nr.\*\*\*\* prot., nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Arkivit Qendror, konfirmon se znj. Merita Hoxha për periudhën janar 2010 - dhjetor 2012, ka realizuar këto të ardhura mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi, në subjektin “Delta Pharma-Al” si vijon:

1. Për periudhën janar 2010 - dhjetor 2010, të ardhurat nga paga në shumën 222.000 lekë.
2. Për periudhën janar 2011 - dhjetor 2011, të ardhurat nga paga në shumën 227.000 lekë.
3. Për periudhën janar 2012 - dhjetor 2012, të ardhurat nga paga në shumën 264.000 lekë.

52. Trupa e vlerësimit, në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në përmbushje të hetimit administrativ ka kërkuar informacion nga bankat e nivelit të dytë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore nga ku:

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr.\*\*\*\* prot., datë 08.05.2023, përcjell CD që konfirmon se Merita Hoxha, ka llogari page dhe për periudhën 04.05.2005 - 03.02.2023, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga paga, në shumën rreth 7.116.313 lekë.

✚ **OTP Bank**, me shkresën nr.\*\*\*\* prot., datë 05.05.2023, konfirmon se Merita Hoxha ka llogari rrjedhëse dhe në datën 03.03.2023 i janë kredituar të ardhura neto nga paga “Delta Pharma-Al” në shumën 75.000 lekë.

✚ **Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Merita Hoxha për periudhën janar 2012 - mars 2023, ka përfituar të ardhura neto nga paga, nga “Delta Pharma-Al”.

52.1 Në proces-verbalin e datës 30.06.2023, mbajtur pranë ILDKPKI-së, dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti paraqiti dokumentacionin për punësimin e bashkëshortes, në periudhën nga 1992 - 2003, si më poshtë vijon:

- Vërtetim nr. \*\*\*V, datë 21.06.2023, nga Komisariati i Policisë Sarandë, që konfirmon se znj. Merita Hoxha për periudhën 21.02.1999 - 30.09.1999, është trajtuar me pagesë kalimtare, si bashkëshortja e punonjësit të policisë Fatmir Hoxha, Shef i Policisë Kriminale në Komisaratin e Policisë Delvinë, në shumën 42.200 lekë;
- Vërtetimin nr. \*\*\*\* prot., datë 29.09.2022, nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, që konfirmon se znj. Merita Hoxha për periudhën 01.10.1999 - 01.03.2003, është trajtuar me pagesë kalimtare si bashkëshortja e punonjësit të policisë Fatmir Hoxha, me detyrë Shef Komisarati në Komisaratin e Policisë Korçë, në shumën 473.590 lekë.

### ***Konkluzion:***

52.2 **Trupa e vlerësimit në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar**, konstaton përputhshmëri midis deklaramit të të ardhurave të personit të lidhur dhe dokumentacionit të administruar nga hetimi kryesisht.

## **A/9 DEKLARIMI I PERSONIT TË LIDHUR VAJZËS EDEN HOXHA**

### **Pasuria nr 1.**

- ❖ **Llogari Bankare**, për pagat në Raiffeisen Bank, me nr. llogarie \*\*\*\*\*, gjendje 28.000 euro, në muajin janar 2023. **Burimi i krijimit:** të ardhura nga paga nga punësimi pranë “Amicius Pharma” dhe “Delta Pharma-AI”. **Vlera** 28.000 euro. **Zotëron** 100%.

### **Hetimi i trupës së vlerësimit:**

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr.\*\*\* prot datë 08.05.2023, konfirmon se Eden Hoxha ka llogari rrjedhëse në euro me gjendje në datën 08.03.2023, në shumën 28.602 euro. Për periudhën 13.07.2017 - 20.01.2023, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat nga “Amicius Pharma” dhe “Delta Pharma -AI”, në shumën rreth 29.741 euro.  
Në llogarinë përveç kreditimit nga pagat, për periudhën 04.9.2019 - 20.01.2023 i janë kredituar nga Merita Hoxha, **shuma rreth 10.359 euro.**

53. **Në proces-verbalin e datës 30.06.2023, mbajtur pranë ILDKPKI-së**, dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit, subjekti sqaroi se:

- “në muajin janar 2023, vajza Eden Hoxha kishte gjendje në llogari të Raiffaisen Bank, në shumën rreth 28.000 euro me burim të ardhurat nga paga e saj pranë shoqërive “Amicus Pharma dhe

“Delta Pharma-Al” dhe në muajin mars 2023, gjendja e kësaj llogarie është 28.602 euro. Vajza kur ka plotësuar deklaratën e pasurisë ka deklaruar gjendjen e llogarisë në muajin janar 2023.

- Lidhur me kreditimin nga bashkëshortja Merita Hoxha, në llogarinë e vajzës Eden Hoxha për periudhën shtator 2019 - shkurt 2023. Transfertat e kryera nga Merita Hoxha në llogarinë e vajzës Eden Hoxha, i përfiton nga kompania “Delta Pharma-Al” në monedhën lekë dhe pasi konvertoheshin në monedhën euro nga Merita Hoxha, derdeshin prej saj në llogarinë e vajzës. Kreditimet nga Merita Hoxha në llogarinë e Eden Hoxha të konstatuara për periudhën shtator 2019-shkurt 2023, në shumën 10.359 euro, në Raiffeisen Bank ishin nga të ardhurat e pagave”.

- **Subjekti paraqiti:**

- Deklaratë datë 15.06.2023, nga përfaqësuesi ligjor i kompanisë “Delta Pharma - Al”.

53.1 Në deklaratën e mësipërme të administruar nga trupa e vlerësimit konfirmohet se Merita Hysen Hoxha, me nr. ID G\*\*\*\*\*C, është e punësuar pranë kësaj kompanie dhe ka tagrin e kryerjes së çdo lloj veprimi si: derdhje në llogaritë bankare, transferata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, transferata për kalim pagash në çdo sportel banke të nivelit të dytë ku kompania “Delta Pharma-Al ka llogari.

53.2 **Hetimi i trupës se vlerësimit**, referuar fakteve të mësipërme, deklaratës së Kompanisë “Delta Pharma - Al” shpjegimeve të dhëna nga subjekti i vlerësimit në proces-verbalin e datës 30.06.2023, thelloi hetimin si më poshtë vijon:

- ✚ Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 12.09.2023, trupa e vlerësimit ka kërkuar nga “Delta Pharma - Al”, informacion në lidhje me mënyrën e pagesës dhe monedhën që kryet pagesa për znj. Eden Hoxha dhe informacion mbi detyrat e kryera nga znj. Merita Hoxha. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.09.2023, “Delta Pharma - Al”, ka kthyer përgjigje duke shprehur se:

1. Znj. Eden Hoxha është e punësuar në shoqërinë tonë dhe ka këtë pagë aktuale:

- Paga bruto 250.000 lekë;
- Paga neto 195,390 lekë;
- Paga paguhet në bazë mujore në llogarinë e punonjësës;
- Monedha me të cilën paguhet paga është Lekë Shqiptar.

2. Znj. Merita Hoxha, është e punësuar pranë shoqërisë sonë në pozicionin arkëtare e shoqërisë pjesë e departamentit të Financës , ajo ka këto përgjegjësi:

- Kryen mbledhjen e parave të gatshme nga klientet për faturimet në mënyrën “pagesë me lekë në dorë”;
- Kryen pagesën e parave të gatshme për furnitorët për faturimet më mënyrën e pagesës “me lekë në dorë”;

- Kryen regjistrimin e veprimeve të arkëtimit dhe pagesave në sistemin e financiar të shoqërisë dhe përgatitjen e distines së parave;
- Depoziton dhe kryen transfertat bankare në emër të shoqërisë për bankat ku është e autorizuar nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë;
- Është person i autorizuar nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë për tërheqjen e statement bankar të shoqërisë nëpër bankat ku shoqëria ka llogari bankare;
- Kryen konvertimet e parave në monedha të tjera sipas nevojave të shoqërisë në institucionet financiare ku është e autorizuar.

53.3 Referuar kthim-përgjigjes së “Delta Pharma - Al”, të dhënave të mbledhura nga llogarit e pagës pranë Raiffeisen Bank për znj. Eden Hoxha, në gjykimin e trupës së vlerësimit rezulton se kalimi i shumave në euro në mënyrë periodike nga znj. Merita Hoxha në llogarinë e znj. Eden Hoxha, janë:

- Të ardhura nga paga të kredituara në llogarinë në lekë, të cilat tërhiqen nga Eden Hoxha dhe i jepeshin cash znj. Merita Hoxha, e cila i konvertonte në monedhën euro dhe i depozitonte në llogarinë në monedhën “euro” të vajzës së saj Eden Hoxha”.

#### **Konkluzion:**

53.4 **Trupa e vlerësimit konstaton se, konfirmohet burimi i krijimit të kësaj pasurie me të ardhurat e deklaruar nga personi i lidhur me subjektin e vlerësimit.**

- ✚ Nga verifikimet e bëra nga trupa e vlerësimit në korrespondencën e përcjellë ndërmjet ILDKPKI dhe bankave të nivelit të dytë, **OTP Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.05.2023, konfirmon se Eden Hoxha ka llogari rrjedhëse dhe në datën 03.03.2023, i janë kredituar të ardhura neto nga paga nga “Delta Pharma - Al”, në shumën 159.404 lekë.
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.05.2023, konfirmon se shtetasja Eden Fatmir Hoxha me nr. ID J\*\*\*\*\*C, rezulton e regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, si Administratore në subjektin “Genera - Qendër Studimesh Sociale Zhvillimi Komuniteti”, me nr. Nip-t L42109453M, e vlefshme nga data 20.09.2018.
- ✚ **Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.06.2023, konfirmon se shtetasja Eden Fatmir Hoxha, me nr. ID J\*\*\*\*\*C, rezulton e regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, si Administratore në subjektin “Genera - Qendër Studimesh Sociale Zhvillimi Komuniteti”, me nr. Nip-t L42109453M, e regjistruar në sistemin tatimor c@ts, në datën 09.09.2014. **Veprimtaria:** Aktivitete të organizatave jofitimprurëse; **Statusi:** “**Organizatë Jofitimprurëse**”.
- Bashkëlidhur informacioni për xhiron e deklaruar dhe fitimi i realizuar nga ky subjekt sipas të dhënave të deklaratave të dorëzuara në sistemin c@ts, për periudhën deri në datën 08.03.2023.

#### **Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit:**



70. **Për kthim-përgjigjet nga Drejtoria e Përgjithshme Tatimore dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirana**, subjekti sqaroi se vajza Eden Hoxha është regjistruar si administratore pranë “Genera-Qendër Studimesh Sociale Zhvillimi Komuniteti” që nga 12.01.2018, por si vullnetare pasi kjo është një organizatë jofitimprurëse. Sqaroi se paga bruto e saj ka qenë 0, por organizata ka bërë deklaram në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, vetëm të sigurimeve shoqërore, në masën e pagës minimale, në përputhje me legjislacionin. Gjithashtu sqaroi se të ardhurat e vajzës Eden Hoxha, konfirmohen saktësisht nga llogarit bankare të pagës, në Credins Bank dhe Raiffeisen Bank.

○ Subjekti i vlerësimit paraqiti:

- Vërtetim datë 12.06.2023 nga organizata jofitimprurëse “Gener - Qendra Sociale e Zhvillimi Komuniteti” me nr. Nip-t L42109453M, që vërteton se, Eden Hoxha është e regjistruar pranë këtij subjekti si Drejtore Ekzekutive nga data 12.01.2018, dhe duke filluar nga kjo datë në emër të znj. Hoxha në listë pagesën E - sig\*\*\*, është deklaruar paga bruto dhe paga për efekt të sigurimeve shoqërore, në masën e pagës minimale.

✚ **Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Eden Hoxha për periudhën mars 2016 - mars 2023 ka përfituar të ardhura neto nga paga, nga personi fizik “V.Xh”, “Delta Pharma - Al”, “Amicus Pharma”, “Genera - Qendër Studimesh Sociale Zhvillimi Komuniteti”, në shumën rreth 13.072.909 lekë.

70.1 Në lidhje me të ardhurat e konfirmuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për personin e lidhur e punësuar si Drejtore Ekzekutive në “Genera - Qendër Studimesh Sociale Zhvillimi Komuniteti”, trupa e vlerësimit verifikon faktin që në sistemin bankar të pagave të znj. Eden Hoxha nuk figurojnë derdhje pagesash në cilësinë e “pagës”.

✚ **Credins Bank**, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 12.06.2023, konfirmohet se shtetasja Eden Hoxha ka llogari page dhe për periudhën 10.12.2014 - 01.06.2019, i janë kredituar të ardhura neto nga pjesëmarrja në projekte dhe trajnime nga “Genera- Qendër Studimesh Sociale Zhvillimi Komuniteti”, në shumën 534.800 lekë.

71. **Në proces-verbalin e datës 30.06.2023, mbajtur pranë ILDKPKI-së**, dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti deklaroj se për konkluzionin nga Credins Bank, që konfirmon kreditimin për periudhën 10.12.2014 - 01.06.2019, në shumën rreth 535.000 lekë, në llogarinë e pagës së vajzës Eden Hoxha, nga pjesëmarrja në projekte dhe trajnime nga “Qendra Genera për Studime Sociologjike”, sqaroi se këto të ardhura nuk janë deklaruar nga Eden Hoxha, pasi ajo ka vlerësuar se duhet të deklaronte të ardhurat aktuale nga pagat që ajo përfiton pranë kompanive “Amicius Pharma” dhe “Delta Pharma.”

72.1 **Për kthim-përgjigjen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, lidhur me të ardhurat neto nga paga, nga subjektin person fizik, “V.Xh” dhe “Genera-Qendër Studimesh Sociale Zhvillimi Komuniteti” sqaroi se, vajza Eden Hoxha nuk ka përfituar të ardhura nga paga nga subjekti “V.Xh” dhe “Genera-

Qendra e Studimeve Sociale” por ka derdhur vetëm kontributet për efekt të sigurimeve shoqërore. Sqaroi se për periudhën mars - nëntor 2016 ka qenë e regjistruar si praktikante tek subjekti “V.Xh” me nr. Nip-t K\*\*\*\*\*C, në vijim të kurrikulës studimore të vitit të pestë, Dega Farmaci, Fakulteti i Mjekësisë. Janë deklaruar vetëm pagat minimale për efekt të sigurimeve shoqërore sipas legjislacionit në fuqi.

- Subjekti paraqiti:
- Vërtetim i datës 15.06.2023, nga subjekti “V.Xh”, person fizik me nr. Nip-t K\*\*\*\*\*C, që konfirmon se për periudhën mars - nëntor 2016, znj. Hoxha në listëpagesën E- Sig\*\*\* është deklaruar paga bruto dhe pagë për efekt të sigurimeve shoqërore, në masën e pagës minimale.

### **Konkluzion:**

**72.2 Trupa e vlerësimit nga verifikimi i llogarive bankare të pagës dhe ato personale të personit të lidhur (vajzës së subjektit të vlerësimit), konstatoi se nuk janë bërë derdhje “pagesash” nga person fizik “V.XH”, dhe “Genera- Qendër Studimesh Sociale Zhvillimi Komuniteti”, konfirmohet deklarimi i subjektit të vlerësimit.**

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 08.05.2023, ka konfirmuar se znj. Eden Hoxha ka llogari për tërheqje në Master Card në euro, e hapur në datën 17.04.2019 me limit 1.200 euro. Gjendje në datën 08.03.2023 në vlerën - 849 euro.

72. Gjendur para këtij fakti, me e-mailin e datës 25.10.2023, relatorja e çështjes ka pyetur subjektin e vlerësimit në lidhje me arsyen e mosdeklarimit, ku me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.11.2023 subjekti i vlerësimit ka deklaruar si më poshtë vijon:

- *“Eden Hoxha ka aktive Master Card, që mban gjendje 1200 euro e hapur kjo nga llogaria e pagës së saj. Dhe kjo gjendje -849 euro është nga blerjet që ka kryer online për nevojat e saj. Këto janë veprime te thjeshta rutinë.*

### **A/10 DEKLARIMI I TË ARDHURAVE TË PERSONIT TË LIDHUR VAJZËS EDEN HOXHA**

- Të ardhura si e punësuar nga data 01.06.2017 deri në 14.02.2023, pranë kompanisë “Amicius Pharma” sh.p.k Shuma 5.395.215 lekë
- Të ardhura nga punësimi pranë kompanisë “Delta Pharma - Al”, kam përfituar të ardhura neto në vlerën 6.090.008 lekë, nga periudha 01.03.2017 deri në janar 2023. Të ardhurat në total në shumën 11.485.223 lekë.
- **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim page datë 07.03.2023, nga kompania “Delta Pharma-Al”sh.p.k, me nr. Nip-t K\*\*\*\*\* U, që deklaroi se znj. Eden Hoxha me nr. personal J\*\*\*\*\*C, ka qenë e punësuar pranë kësaj kompanie nga data 01.03.2017 e në vijim, me pagë neto si më poshtë vijon:
  1. Për periudhën mars 2017 - maj 2017, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në shumën 120.000 lekë.
  2. Për periudhën mars 2018 - dhjetor 2018, ka përfituar të ardhurat neto nga paga, në shumën 500.000 lekë.
  3. Për periudhën janar 2019 - dhjetor 2019, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në shumën 1.050.000 lekë.
  4. Për periudhën janar 2020 - dhjetor 2020, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në shumën 1.120.000 lekë.
  5. Për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në shumën 1.576.508 lekë.
  6. Për muajin janar 2023 ka përfituar të ardhura neto nga paga, në shumën 135.500 lekë.
  
- Vërtetim page datë 6.3.2023, nga Kompania “Amicius Pharma” sh.p.k me nr. Nip-t L\*\*\*\*\*Q, që deklaroi se znj. Eden Hoxha, me nr. personal, J\*\*\*\*\*C, ka qenë e punësuar pranë kësaj kompanie nga data 01.06.2017 deri në 14.02.2023 si Menaxhere për Çështjet Rregullatore dhe Farmakovigjilencën me pagë neto si më poshtë vijon:
  1. Për periudhën qershor 2017 - dhjetor 2017, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në shumën 554.685 lekë.
  2. Për periudhën janar 2018 - dhjetor 2018, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në shumën 915.304 lekë.
  3. Për periudhën janar 2019 - dhjetor 2019, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në shumën 887.028 lekë.
  4. Për periudhën janar 2020 - dhjetor 2020, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në shumën 894.541 lekë.
  5. Për periudhën janar 2021 - dhjetor 2021, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në shumën 882.012 lekë.
  6. Për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në shumën 1.013.233 lekë.
  7. Për periudhën janar 2023 - dhjetor 2023, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në shumën 248.412 lekë.

***Konkluzion:***

73. **Trupa e vlerësimit në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar**, konstaton përputhshmëri midis deklaramit të të ardhurave të personit të lidhur dhe dokumentacionit të administruar nga hetimi administrativ.

## A/11 DEKLARIMI I PERSONIT TË LIDHUR, DEKLARIMI I TË ARDHURAVE I VAJZËS FJONA HOXHA

- ❖ Të ardhura nga punësimi im në sektorin privat, për periudhën tetor 2018 deri në janar 2023. Shuma 2.029.741 lekë.

### **Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit:**

- + **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 08.05.2023, përcjell CD që konfirmon se Fjona Hoxha ka llogari page, në monedhën lekë dhe për periudhën 05.11.2018 - 31.12.2018, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat nga “A. D” person fizik, në shumën rreth 63.936 lekë.
- + **Banka Kombëtare Tregëtare**, me shkresën me nr.\*\*\* prot., datë 09.05.2023, konfirmon se Fjona Hoxha ka llogari rrjedhëse dhe për periudhën 08.04.2022 - 10.02.2023, i janë kredituar në llogari të ardhura neto, nga pagat nga “Infosoft Office” sh.p.k, në shumën rreth 748.086 lekë.
- + **Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën me nr.\*\*\* prot., datë 19.05.2023, konfirmon se Fjona Hoxha ka llogari rrjedhëse dhe për periudhën 13.3.2019 - 30.12.2019, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat, nga “Turbo Albania” sh.p.k, në shumën rreth 321.207 lekë.
- + **Abi Bank**, me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Fjona Hoxha ka llogari page dhe për periudhën 28.02.2020 - 29.01.2021, i janë kredituar në llogari të ardhura nga paga dhe bonuse nga “Tranzit” sh.p.k, me shumën rreth 430.948 lekë.
- + **Credins Bank**, me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 15.05.2023, konfirmon se Fjona Hoxha, ka llogari page dhe për periudhën 02.03.2021 - 05.04.2022, i janë kredituar të ardhura nga paga nga “Start Co” sh.p.k, me shumën 603.300 lekë. Fjona Hoxha, ka pasur llogari rrjedhëse për fëmijët dhe për periudhën 29.12.2009 - 03.01.2011, i janë kredituar në llogari të ardhura nga shkolla “Naim Frashëri” në shumën 24.000 lekë.
- + **Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Fjona Hoxha për periudhat tetor 2018-mars 2023, ka përfutur të ardhura neto nga pagat, nga “A. D” person fizik, “Turbo Albania” sh.p.k, “Tranzit” sh.p.k. “Start Co” sh.p.k, “Infosoft Office” sh.p.k.

### **73 Konfirmohen deklaratimet e personit të lidhur me informacionet e administruara me informacionet ligjzbauese dhe bankat e nivelit të dytë.**

### **A/12 Konkluzionet nga institucionet që nuk konfirmojnë të kenë informacione për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur me të:**

1. Banka e Shqipërisë, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ProCredit Bank, Banka e Parë e Investimeve, Union Bank, Raiffeisen Leasing, Porche Leasin, Albania Leasing, Landeslease, Easypay, Fondi

Besa, Institucioni Financiar Nova, Iute Credit Albania, konfirmojnë se subjekti Fatmir Hoxha dhe personat e lidhur me të **nuk janë klient të tyre**.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Fatmir Resmi Hoxha, Merita Hysen Hoxha dhe Fjona Fatmir Hoxha, **nuk figurojnë** të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.
3. Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.05.2023, **nuk konfirmon** mjete lundruese në pronësi të Fatmir Hoxha dhe familjarëve të tij.

**74 Nëpërmjet hetimit të zhvilluar kryesisht, trupa e vlerësimit**, në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, me shkresën nr.\*\*\*prot., datë 11.09.2023 kërkoj nga Regjistrit Noterial pranë Ministrisë së Drejtësisë informacion në lidhje me aktet e kryera nga subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, nga ku, në kthim-përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 18.09.2023 u konstatua se:

✚ Personi i lidhur bashkëshortja e subjektit, znj. Merita Resmi Hoxha me nr. ID G\*\*\*\*\*C e datëlindjes 11.07.1962, ka qenë palë në kontratën, me nr. rep 1086., nr. kol 635., datë 05.10.2021, “*Kontratë dhurimi pasurie të paluajtshm*”.

74.1 Trupa e vlerësimit në shterim të faktit të dalë nga kthim-përgjigje e mësipërme, ju drejtua me shkresë zyrës së notërisë ku është kryer akti i mësipërm dhe me kthim-përgjigjen nr. \*\*\*, datë 29.09.2023, u administruar akti me nr. 1086 rep., nr. kol 635., datë 05.10.2021 “*kontratë dhurimi pasurie e paluajtshme*” ku aktet bashkëlidhur kontratës së dhurimit u konstatua se znj.Merita Hoxha, në momentin e hartimit të këtij akti figuron bashkëpronare, në pjesë takuese 2/10 mbi pasurinë apartamentit, me sipërfaqe 93m<sup>2</sup>, e ndodhur në rrugën “Irfan Tomini”, në zonën kadastrale nr.\*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*\*, me vol.\*\*\*, fq\*\*\*.

- Nga akti i certifikatës së pronësisë, rezultojnë bashkëpronar në pjesë takuese si më poshtë vijon:
  - S. L- pjesë takuese 2/10;
  - Merita Hysen Levanaj -pjesë takuese 2/10;
  - S. L- pjesë takuese 1/10;
  - E. L - pjesë takuese 1/10;
  - L. L- pjesë takuese 2/10;
  - E. L - pjesë takuese 1/10;

Në datën 05.10.2021, shtetasit e sipërpërmendur, bashkëpronar të apartamentit me sipërfaqe 93 m<sup>2</sup>, kanë dhuruar pjesët e tyre takuese në favor të bashkëpronarit E. L.

74.2 Apartamenti me sipërfaqe banimi 93 m<sup>2</sup>, me adresë në rrugën “Irfan Tomini”, ku shtetasja Merita Hoxha, gëzonte cilësinë e bashkëpronares, deri në datën 05.10.2021, datë në të cilën bëri dhurimin e pjesës së saj takuese, nuk rezulton e pasqyruar në deklarinimin e pasurisë së personit të lidhur sipas pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

74.3 Relatorja e çështjes, me e-mailin e datës 08.10.2023<sup>7</sup>, ka kërkuar informacion nga subjekti i vlerësimit, në lidhje me konkluzionin e sipërpërmendur.

✚ Subjekti i vlerësimit me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 10.10.2023, ka dhënë shpjegime si më poshtë vijon:

- *“Në përgjigje të e- mailit tuaj dua t’ju sqaroi se, përsa i përket kontratës së dhurimit të pasurisë së paluajtshme, të bashkëshortes sime Merita Hoxha, me nr. rep 1086., datë 05.10.2021, ku ka rezultuar bashkëpronare në vlerën 2/10, e pasurisë së apartamentit, me sipërfaqe 93 m<sup>2</sup>, e ndodhur në rrugën “ Irfan Tomini “, në zonën kadastrale nr. \*\*\*, me nr. pasurie nr.\*\*\*\* me vol .\*\*, fq \*\*\*, bashkëshortja ime, në datën 05.10.2021, ja ka dhuruar pjesën e saj takuese në favor të nipit të saj E. Levanaj.*
- *Babai i ndjerë i bashkëshortes (Hysen Levanaj), pas shitjes së apartamentit të mëparshëm, me anë të kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 17.11.2006, ka blerë apartamentin në Tiranë, të regjistruar pranë ZVRPP Tiranë, me nr.\*\*\*, me nr. pasurie nr.\*\*\*\*\*, me vol .\*\*, fq \*\*\*.*
- *Ky pasqyrim i deklaramit tim mungon, pasi prej asaj pasurie nuk është përfituar asnjë lloj transaksioni, mbajtja e kësaj pasurie ishte shumë e shkurtër, pasi direkt është dhuruar tek nipi i saj dhe nuk është realizuar asnjë transaksion apo veprim tjetër ligjor”.*

74.4 Nga përgjigjet e subjektit të vlerësimit, trupa nuk ka mundur të siguroj të gjithë elementet e nevojshëm dhe të kërkuar prej saj, nëpërmjet e-mailit të dërguar nga relatorja e çështjes, së përmendur në pikën 75.1, të këtij relacioni dhe në vazhdim ka rikërkuar me e-mailin e datës 25.10.2023<sup>8</sup>, nga subjekti të vendosi në dispozicion aktin e çeljes së trashëgimis, për të verifikuar periudhën se kur personi i tij i lidhur është bërë pronare e pjesës takuese, mbi apartamentin me sipërfaqe 93 m<sup>2</sup> . Ku përsëri me kthim - përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 01.11.2023, nuk ka vënë në dispozicion “*aktin e çeljes së trashëgimisë*”, por është mjaftuar vetem me paraqitjen e certifikatës së vdekjes, së shtetasit Hysen Levanaj (vjehtëri i subjektit).

74.5 Trupa e vlerësimit, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 03.11.2023, ka kërkuar nga ASHK Tiranë, “aktin e çeljes së trashëgimisë” dhe më kthim-përgjigjen nr.\*\*\* prot., datë 13.11.2023, ka mundur të siguroj dokumentacionin e kërkuar.

- Aktin e çeljes së trashëgimisë me nr .578 rep., nr. 343 kol., datë 02.07.2018.

---

<sup>7</sup>1. Mënyrën e fitimit të pronësisë me pjesë takuese 2/10, nga ana e bashkëshortes suaj znj.Merita Hoxha, mbi apartamentin e banimit 93m<sup>2</sup> në rrugën Irfan Tomini.

2. Kohën (datën, muajin,vitin) kur znj.Merita Hoxha ka fituar cilësinë e bashkëpronarit mbi pjesën takuese 2/10 mbi këtë pasuri.

3. Pse mungon pasqyrimi i kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë së personit të lidhur znj.Merita Hoxha, ku referuar pikës 1 të nenit 32 të ligjit 12/2018 i ndryshuar ka detyrimin ligjor për ta deklaruar?

<sup>8</sup> Kërkojë nga ana juaj të na vini në dispozicion dokumentacion konkretisht certifikatën e vdekjes së vjehtërit tuaj z..\*\*\* Levanaj si dhe dëshminë e çeljes së trashëgimisë sipas nenit 348 të Kodit Civil.

74.6 Trupa e vlerësimit ka siguruar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2023, nga ILDKPKI deklarinimet vjetore të subjektit të vlerësimit ndër vite, për të verifikuar faktin në qoftë se personi i lidhur, bashkëshortja ka pasqyruar në delaratën e interesave private, pronësinë mbi 2/10 pjesë, të apartamentit, me sipërfaqe 93m<sup>2</sup>, në rrugën “Irfan Tomini”, Tiranë.

✚ Nga kontrolli i deklarinimeve vjetore, të subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur me të, ka rezultuar se znj. Merita Hoxha, nuk ka deklaruar asnjëherë pronësinë mbi 2/10 pjesë, të apartamentit më sipërfaqe 93 m<sup>2</sup>.

74.7 Trupa e vlerësimit nga të dhënat e faktit, kthim-përgjigjet e subjektit të vlerësimit dhe korrespondenca me institucionet ligjzbatuese **konstaton se:**

1. Znj. Merita Hoxha, është bërë pronare në pjesë takuese, të pasurisë aparatament banimi me celjen e trashëgimisë së datës 02.07.2018, si rezultat i vdekjes së babait të saj, në datën 30.12.2015, (*trashëgimlënësi në marrëdhënien e trashëgimisë*), në aktin e trashëgimisë vërtetohet fakti i pranimit të trashëgimisë, nga ana e përfitueses znj. Merita Hoxha.
2. Znj. Merita Hoxha, e ka ushtruar të drejtat e pronësisë, mbi këtë pasuri nga momenti i celjes së trashëgimisë, datë 02.07.2018 deri në datën 05.10.2021, për një periudhë 3- vjeçare datë kur së bashku me bashkëpronarët e tjerë kanë disponuar pronën më dhurim, në favor të njërit prej bashkëpronarëve shtetasit *E. Levanaj*.

74.8 Trupa e vlerësimit konstaton se mospasqyrimi i kësaj pasurie nga personi i lidhur me subjektin e vlerësimit nuk rezulton në kushtet e mosdeklarimit sipas ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, por është një gabim në mënyrën sesi është kuptuar detyrimi për të deklaruar.

✓ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- **Ka bërë deklarinim të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- **Nuk është kryer deklarinim i rremë;**
- **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**



## B. KONTROLI I FIGURËS

✚ Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme, me personat e përfshirë ose të dyshuar, për përfshirje në krimin e organizuar”.

75 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
- raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërmra (ë), e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

76 Trupa e vlerësimit, ka kryer kontrollin e figurës, së subjektit të vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë së deklarimeve, si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”;
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ **Drejtorja e Analizës dhe Sigurisë së Personelit**, në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dorëzuar nëpërmjet shkresës, nr.\*\*\* prot., datë 20.07.2023, raportin e kontrollit të figurës<sup>9</sup> ku ka konstatuar se:

❖ **Subjekti i vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha, me detyrë Drejtor në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Korçë, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

✚ **Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:**

---

<sup>9</sup> Raporti mbi kontrollin e figurës nr.\*\*\*\*\* datë 20.07.2023

- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka patur apo ka regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- Ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë ndaj tij masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të Ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.

**77** Në mbështetje të neneve 35 - 42, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, trupa e vlerësimit zhvilloj hetimin mbi kontrollin e figurës duke u bazuar në kthim-përgjigjet e institucioneve ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, raportin e Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit dhe deklaratimet e subjektit të vlerësimit **nga ku u konstatua:**

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, me shkresën “I kufizuar” nr. \*\*\*\*\* prot., datë 25.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha, bën me dije se:
  - Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve.
  - Nuk ka ndryshuar shtetësi (lenie ose marrje shtetësie).
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, me shkresën “I kufizuar” nr. \*\*\*\*\* prot., datë 19.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Hoxha bën me dije se:
  - Nuk rezulton i dënuar.
- Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar” nr. \*\*\*\*\* prot., datë 26.05.2023, dhe shkresë “e paklasifikuar” nr. \*\*\*\*\* datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha, si dhe për personat e lidhur sipas certifikatës familjare **nuk kanë:**
  - Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimin e ngritur në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
  - Të dhëna për kontakt të papërshtatshëm, me persona të përfshirë në krimin e organizuar (*sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*) ku mund të përfshihen biseda, foto, vëzhgime takimesh apo biseda telefonike etj;
  - Të dhëna për kontakte të papërshtatshme, me persona (*të dënuar ose proceduar penalisht, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë i ndryshuar*);
  - Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e ndonjë vepre penale;
  - Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar, nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e ndonjë vepre penale;
  - Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë “urdhër-arresti ndërkombëtar”, për kryerjen e një vepre penale;
  - Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
  - Të dhëna për gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s;
  - Të dhëna që nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet;
  - Nuk ka procedime disiplinore apo masa disiplinore, në ngarkim të subjektit të vlerësimit Fatmir Hoxha.

4. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “Konfidencial” nr.\*\*\*\*\* prot., datë 31.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Hoxha bën me dije se:
  - a. Nuk disponon të dhëna.
  
5. **Institucion ligjzbatues**, me shkresë “Sekret” të datës 13.06.2023, dhe shkresën nr. \*\*\*\*\* prot., datë 19.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Hoxha dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare bën me dije se:
  - a. Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të paligjshëm;
  - b. Nuk ka precedent penal të referuar;
  - c. Për subjektin e vlerësimit nuk administrohen ankesa, të dhëna ose informacione.
  
6. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar”, nr \*\*\* prot., datë 05.07.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha bën me dije se:
  - a. Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
  - b. Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
  - c. Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo presonit nën hetim, sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35, të Kodit të Procedurës Penale;
  - d. Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprës penale;
  - e. Nuk ka pasur raste të urdhërit ndërkombëtar të ndalimit.
  
7. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar” nr.\*\*\*\*\* prot., 07.06.2023, bën me dije se, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha:
  - a. Nuk rezulton të jetë regjistruar procedimi penal.
  
8. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “Sekret” nr \*\*\*\*\* prot., datë 25.05.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Fatmir Resmi Hoxha dhe personat e lidhur me të, Merita Hoxha, Eden Hoxha dhe Fjona Hoxha:
  - a. Nuk rezultuan raportime, përveç atyre rutinë.
  
9. **Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën ‘I kufizuar’ nr. \*\*\*\*\*prot., datë 19.05.2023, për subjektin e vlerësimit z.Fatmir Resmi Hoxha bën me dije se:
  - a. Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), niveli i klasifikimit “Tepër Sekret” me nr. CSP \*\*\*\*\* me datë lëshimi 04.11.2021, të vlefshme deri në datën 03.11.2026.
  - b. Për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.

- c. Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie, në lidhje me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

10. **Avokati i Popullit**, me shkresën “E paklasifikuar” me nr. \*\*\*\* prot., datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Hoxha bën me dije se:

- a. Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku, në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin, gjatë kryerjes së detyrës.
- b. Nuk ka nisje të hetimit administrativ, për shkelje të kryera nga subjekti.

11. **Institucion ligjbatues**, me shkresën “ I kufizuar nr. \*\*\* prot., datë 08.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha, bën me dije se:

- a. Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991.

12. **Institucioni ligjbatues**, me shkresën “Sekret” nr. \*\*\*\* prot., datë 30.05.2023, ka bërë me dije se ka disponuar informacione për subjektin e vlerësimit, të cilat pas verifikimeve të kryera kanë rezultuar se nuk janë të dhëna të vërtetuara.

## 78 Denoncime nga publiku:

Për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha, nuk është disponuar asnjë ankese, nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

## 79 Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, nr. \*\*\* prot., datë 06.12.2023, “*Akt ekspertimi*” konkludohet se subjekti i vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha:

- ✚ Aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.

## ✓ Në përfundim të hetimit të kryer për kontrollin e figurës:

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Fatmir Hoxha, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjbatuese, vlerësimit të testit për

përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Fatmir Resmi Hoxha:

- ***Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;***
- ***Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.***

### **C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

80 Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.

81 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

82 Subjekti i vlerësimit z. Fatmir Hoxha, në momentin e dorëzimit të formularit të vlerësimit të aftësisë profesionale datë 08.03.2023, në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Korçë. Në momentin e hedhjes së shortit dhe përzgjedhjes së trupës së vlerësimit datë 05.04.2023, subjekti i vlerësimit mbante po funksionin e Drejtorit të Kufirit dhe Migracionit Korçë”.

✚ Periudha e vlerësimit në zbatim të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, është periudha 5-vjeçare (2018-2023). Porcesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shrihet brenda këtij harku kohor.

### **C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL POLICIA E SHËTETIT.**

83 Struktura e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar

nëpërmjet shkresës nr.\*\*\*\* prot., datë 05.07.2023, raportin e vlerësimit profesional është shprehur me “konkluzion përfundimtar” si më poshtë vijon:

- ✚ **“Punonjësi i policisë z. Fatmir Resmi Hoxha është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban”.**

## **C/2 HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT.**

- ✚ Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me ligjin e vlerësimit si dhe ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ka zhvilluar një hetim administrativ të plotë dhe të bazuar në fakte dhe prova duke u bazuar në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit nr.\*\*\*\*;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.

- ✚ Punonjësi i Policisë, Drejtues Fatmir Resmi Hoxha është emëruar në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Korçë, me urdhërin nr. \*\*\*, datë 18.10.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Fatmir Hoxha e bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

- ✚ **Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit, mbi nivelin e arsimit në përputhje me nenin 43-45 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

### **85. Vlerësimi i nivelit të arsimit:**

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
DND	Shkolla e lartë e Ministrisë së Punëve të Brendshme	1985	1989	Tiranë	Diplome

- Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, administroi nga dosja e subjektit të vlerësimit diplomën me nr. regjistri \*\*\*\*.



- Në kuptim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

#### **Konkluzion:**

**85.1 Trupa e vlerësimit në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, konstaton se subjekti i vlerësimit gëzon nivelin e nevojshëm të arsimit për pozicionin e punës që mban.**

**✚ Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit mbi trajnimet dhe kualifikimet e subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43 - 45 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

#### **86. Certifikatat e trajnimeve, kualifikimet dhe medaljet:**

**✚** Trupa e vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatoj se gjatë periudhës 5 vjeçare të vlerësimit në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

1. nuk ka realizuar asnjë trajnim;
2. nuk ka asnjë kualifikim;
3. nuk ka marrë asnjë certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave.

86.1 Trupa e vlerësimit vë në dukje faktin se, dokumentacioni bashkëlidhur raportit të vlerësimit, përmban certifikata trajnimesh për subjektin e vlerësimit të një periudhë relativisht të hershme, për harkun kohor të viteve 2001 - 2005. Në përputhje me dispozitat e ligjit të vlerësimit, kjo periudhë nuk është objekt vlerësimi dhe për këtë arsye këto kualifikime nuk do të trajtohen në kuadrin e kualifikimeve të përfituara nga subjekti i vlerësimit për periudhën (2018 - 2023)

#### **Konkluzion:**

**86.2 Trupa e vlerësimit konstaton se gjatë periudhës së vlerësimit subjekti nuk gëzon asnjë kualifikim/trajnimi/medalje.**

**✚ Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit mbi vlerësimet e punës, së subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43 - 45, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

#### **87. Vlerësimet e punës:**

**✚** Gjatë zhvillimit të hetimit mbi procesin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupa e vlerësimit ka konstatuar se:

- Për periudhën e vlerësimit (2018 - 2023) në dosjen e subjektit të vlerësimit dhe në raportin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, subjekti ka vetëm një vlerësim pune atë të vitit 2018 me rezultat “shumë mirë”.

87.1 Gjendur në këto kushte trupa e vlerësimit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.07.2023, kërkoj nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, vlerësimet e punës për periudhën 2019 - 2022, ku me kthim-përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 21.07.2023, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Policinë e Shtetit u konfirmua fakti se vlerësimet e punës për periudhën 2019 - 2022 për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Hoxha nuk rezultojnë të administruar në dosjen e personelit.

87.2 Relatorja e çështjes me e-mailin e datës 27.09.2023 kërkoj nga ana e subjektit të vlerësimit paraqitjen e vlerësimeve të punës për periudhën 2019 - 2022. Subjekti i vlerësimit me e-mailin e datës 02.10.2023 ka deklaruar se:

➤ *“nuk i disponon këto vlerësime pune dhe se mund të jenë në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore”.*

87.3 Trupa e vlerësimit gjatë hetimit të zhvilluar, ka konstatuar se nuk është e mundur të disponohen vlerësime pune për periudhën 5 - vjeçare të vlerësimit, sipas nenit 44, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, për arsyen se nuk rezultojnë të administruara në dosjen e personelit dhe as subjekti i vlerësimit nuk i disponon. Për një hetim sa më të plotë, trupa e vlerësimit ka marrë në konsideratë vlerësimet e mëparshme të subjektit të vlerësimit, të cilat kanë rezultuar pozitive.

✚ **Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit, mbi masat disiplinore të subjektit të vlerësimit, në përputhje me nenin 43 - 45, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

### **88. Masat disiplinore:**

Trupa e vlerësimit në zhvillim të hetimit ka kryer verifikime në dosjen personale të subjektit të vlerësimit, si dhe në sistemin RMIS, nga ku rezulton se gjatë periudhës 5 - vjeçare, (2018-2023) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të ligjit 2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.

88.1 **Trupa e vlerësimit konstaton se, subjekti përgjatë periudhës së vlerësimit nuk ka asnjë masë disiplinore në ngarkim.**

✚ **Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit mbi ecurinë në karrierë të subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43 - 45 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

### **89. Ecuria në karrierë.**

Nga verifikimi i të dhënave të deklarimit të subjektit të vlerësimit, raportit të vlerësimit profesional nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, subjekti i vlerësimit Fatmir Resmi Hoxha ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 27 vitesh e 3 muaj. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 5 - vjeçare objekt deklarimi, subjekti mban:

- **Gradën “Drejtues”**

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. urdhëri	Data	
			Nga	Deri
Kryekomisar	Ripranim në Polici	Nr.727/1 datë 10.02.2014	11.02.2014	25.12.2014
Drejtues	Ngritur në gradë	Nr.727/5 datë 29.12.2014	26.12.2014	

89.1 Në zbatim të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, referuar fitimit të gradës policore nga “Kryekomisar” në “Drejtues”, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.727/5, datë 29.12.2014 “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, trupa e vlerësimit konstaton se koha e fitimit të gradës është e vitit 2014, jashtë periudhës 5 - vjeçare objekt vlerësimi.

- **Funksioni “Drejtori i Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit, Korçë”**

Data e fillimit	Data e përfundimit	Institucioni	Funksioni
19.10.2021	Aktualisht	Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Korçë	Drejtor
11.02.2021	18.10.2021	Drejtoria Vendore Policisë Gjirokastrë	Drejtor
28.04.2017	31.05.2017	Drejtoria Vendore Policisë Berat	Zv/Drejtor

89.2 Nga të dhënat e faktit konstatohet se subjekti i vlerësimit gjatë periudhës së vlerësimit, ka mbajtur funksionin “Drejtor” në përputhje me kriteret ligjore dhe gradën që disponon.

89.3 **Trupa e vlerësimit** në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit, z. Fatmir Hoxha arrin në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe grada që ai ka përfituar, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

**Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit mbi pjesëmarrjen në konferenca shkencore, ëorkshope seminare, të subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43 - 45, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

**90. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshope, seminare botime brenda dhe jashtë vendit.**

Trupa e vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatoj se gjatë periudhës 5-vjeçare të vlerësimit, në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit nuk rezulton të ketë marrë pjesë në konferenca shkencore, workshope apo seminare.

90.1 Trupa e vlerësimit vë në dukje faktin se dokumentacioni bashkëlidhur raportit të vlerësimit përmban certifikata pjeësmarrjes në workshope të subjektit të vlerësimit për vitin 2015, periudhë kohore e cila nuk është e përfshirë në objektin e vlerësimit të aftësive profesionale.

✓ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit Fatmir Hoxha;

- ✚ **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- ✚ **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- ✚ **Ka vlerësime pozitive pune.**

**Konkluzione përfundimtare:**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 16.01.2024, ftoj subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 22.01.2024, dhe arrin në kokluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Fatmir Resmi Hoxha, në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;***
- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;***
- ***Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.***

**PËR KËTO ARSYE:**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

**V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit Fatmir Resmi Hoxha me funksion aktual Shef Sektori ai dhe Zëvendës drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

*Ky vendim u shpall sot datë 22.01.2024, në Tiranë.*

**KRYESUES**

**ENTON RADOVANI**

**RELATOR**

**KLEADA MERSINLLARI**

**ANËTAR**

**EDONA DUSHAJ**

## Shtojca.1 (Analiza financiare të ardhura dhe shpenzime)

Burimi/Viti	Pasqira e Analizes Financiare																	
	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Janar-shkurt2023	TOTALI	TOTALI
Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit Z.Fatmir Hoxha	558,093	583,590	201,588	201,588	201,558	361,558	904,531	1,353,347	1,288,223	1,146,678	1,160,877	1,171,342	1,311,916	3,189,530	1,260,106	176,320		
Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit Znj. Merita Hoxha	204,000	212,000	222,000	227,000	264,000	235,596	250,848	250,848	607,592	587,592	675,576	704,904	780,789	764,904	880,872	146,812		
Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit Znj. Eden Hoxha									198,000	704,432	1,386,430	1,897,676	1,998,332	2,538,878	2,406,832	387,222		
Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit Znj. Fiona Hoxha											65,325	316,031	440,862	313,366	738,940	148,772		
Të ardhura neto nga interesat bankarë																		
Të ardhura nga Remitancat																		
Të ardhura nga pasuria intelektuale licenca, drejta ekskluzive.																		
Te ardhura te krijuara nga shitja e pasurive te luajshme dhe te paluajshme																		
Të ardhura të realizuara jashtë territorit të Shqipërisë																		
Te ardhura te krijuara nga investimi ne titull																		
Të ardhura të pa përmendura më lart																		
Te hyra nga dhurimet																		
<b>Totali i të Ardhurave dhe te hyrat</b>	762,093	795,590	423,588	428,588	465,558	597,154	1,155,379	1,604,195	2,093,815	2,438,702	3,288,208	4,089,953	4,531,899	6,806,678	5,286,750	859,726	-	-
<b>Detyrime: Te hyra nga huatellkredi</b>																		
Shpenzime jetike sipas INSTAT	546,480	853,008	853,008	853,008	558,192	558,192	944,568	953,484	982,740	970,500	1,028,868	1,107,192	1,118,700	1,138,608	1,168,144	198,024		
Shpenzime per arsimin e femijeve					26,660	26,660	78,860	78,860	78,860	52,200								
Shpenzime për Mjekim																		
Shpenzime për blerje automjeti									276,000									
Shpenzime Udhëtimi jashte vendit														24,440		392,370		
Shpenzime Kredie Bankare Leasing, etj																		
Shpenzime dhe te dalat te tjera.																		
<b>Totali i shpenzimeve dhe te dalave</b>	546,480	853,008	853,008	879,668	584,852	637,052	1,023,428	1,032,344	1,337,600	1,022,700	1,028,868	1,107,192	1,118,700	1,163,048	1,168,144	590,394	-	-
Investime pasuri																5,588,549		
Likuiditete (ndryshimi: shtim Ipakesim)																		
Gjendje Cash (ndryshimi: shtim Ipakesim)																		
<b>Totali Pasuri</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	5,588,549	-	-
<b>Mundesia per Kursime : Te Ardhura+Detyrime-Shpenzime-Pasuri.</b>	215,613	158,195	- 271,225	- 722,305	- 841,599	- 881,497	- 749,546	- 177,695	578,520	1,994,522	4,253,862	7,236,623	10,649,822	16,293,452	20,392,058	15,072,841	15,072,841	15,072,841